

Anila Bani

LIBËR PËR MËSUESIN
Ekonomia 12

BOTIME



BOTIME



Paraqitja grafike: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, qershor 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sktori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

Hyrje	5
Planifikimi i kurrikulës	16
Modele planifikimi të orëve mësimore	28

TË NDERUAR KOLEG, MËSUES TË EKONOMISË

Procesi i arsimimit dhe edukimit të të rinjve është përherë sa sfidues edhe motivues. E përditshmja e cilitdo prej nesh kërkon përditësim të dijeve e njohurive, fleksibilitet, përshtatje, iniciativë, motivacion, respekt ndaj vetvetes dhe ndaj nxënësve tanë. Puna jonë përcjell ndjenjën e përkushtimit, empatisë, përgjegjësia për breza që formohen ditë pas dite. Arsimi çdo ditë e më shumë tregon se është mjedisi social-kulturor-shkencor dinamik në të cilin “gatuhet” e ardhmja e shoqërisë. Mësimi i Ekonomisë sikurse arsimi në përgjithësi, në këtë shekull duket se po udhëhiqet nga një filozofi e cila:

- ☞ ka në qendër nxënësin;
- ☞ përbushjen e kurrikulës e mbështetet në projekte dhe në realitetin ekonomik që nxënësit përjetojnë e prekin në përditshmëri në problemet ekonomike që hasin në të;
- ☞ të nxënit në këtë fillim shekull e orienton mbi ato që nxënësit duhet të dinë, ato që mund të bëjnë, dhe atë që do të ndodh me nxënësit, pasi fitohen dijet;
- ☞ të nxënit e mbështet në hulumtim dhe nxënie aktive;
- ☞ nxënësit i nxit e i motivon të jenë bashkëpunues jo vetëm me shokët e klasës, por dhe moshatarët e tyre në klasa paralele brenda e jashtë vendit fal teknologjisë së komunikimit.

Gjithçka përmendëm më sipër, në këtë epokë digjitale mundësohet e lehtësohet edhe nga përdorimi dhe integrimi si instrument mësimor në procesin e mësimdhënies e nxënies edhe e:

- ☞ internetit për të shfrytëzuar librarit elektronike dhe faqet elektronike si burim informacioni për njohuri për ekonominë;
- ☞ postës elektronike për shkëmbimin e informacionit;
- ☞ programeve kompjuterike për mbledhjen e të dhënave, përpunimin, analizën dhe prezantimin e tyre.

Lënda e ekonomisë ofron mundësi të shumta që të edukojmë e të formojmë nxënës që dinë të bëjnë shumëçka në të mirë të tyre apo shoqërisë. Ne, si mësues duhet të zhvillojmë orë mësimore bazuar në:

- ☞ ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- ☞ shfrytëzimin e përvojave personale e familjare të nxënësve;
- ☞ pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- ☞ pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinionëve vetjake;
- ☞ përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Pajisja jo vetëm me aftësi, por edhe me kompetenca arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis

mësimdhënies dhe të nxënit.

Programi i kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar e sociologjik dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënit, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm ndërmjet nxënësve dhe mësuesit, ndërmjet punës në grupe të vogla dhe të mëdha, ndërmjet punës së pavarur dhe asaj individuale, duke i dhënë përparësi nxitjes së ideve të ndryshme, të shumta të dala nga nxënësit, reflektimit kritik të tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Me rëndësi vlerësohen rezultatet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore, gazeta ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Rezultatet e nxënësve vlerësohen si tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Përgjatë rrugëtimit tonë si mësimdhënës e formues të brezave që ndryshojnë shpejt e cilësisht, besoj se të gjithë jemi gjendur e gjendemi në situata në të cilat ajo çka ne e quajmë misionin tonë dhe detyrën tonë të përditshme të jetë kthyer në një sfidë të vërtetë. Kështu pra, në jo pak raste na është dashur e na duhet të gjendemi përpara dilemës se sa dhe si duhet të ndryshojmë në mënyrë që ritmi dhe synimet tona të jenë në një sintoni me ato të brezave që edukojmë e formojmë, që synimet tona të kenë qasje maksimale me ato të tyre, që objektivat tona të jenë jo vetëm kryefjala e përgatitjes sonë ditore, por edhe qëllimi final i orëve tona. Pa dyshim që të gjithë dëshirojmë të jemi sa më të suksesshëm në atë që bëjmë dhe që arrijtjet e nxënësve tanë jo vetëm të mbërrijnë, por edhe të kapërcejnë pritshmëritë tona. Por, nga ana tjetër, të gjithë ne mësuesit e Ekonomisë së zbatuar duket se duhet të sfidojmë veten dhe arrijtjet tona çdo ditë, pasi kjo lëndë duke qenë shkenca që analizon, përligj e argumenton realitetin ekonomik, është jo vetëm pasqyrë e dinamikave të këtij realiteti, por edhe çelësi që na bën të kuptojmë më mirë këtë realitet e na mundëson që të bëjmë zgjedhje optimale në çdo moment.

Reformat arsimore si edhe rritja e interesit për këtë lëndë kanë qenë nxitësit kryesorë që na kanë venë përballë faktit që kjo lëndë duhet të jetë në dinamikë cilësore të vazhdueshme, dinamik e cila duhet të konkretizohet në ndryshime konkrete e të prekshme.

A duhet të ndryshojmë nga praktika jonë dhe nëse po, çfarë do të ndryshojmë?

Për ne si mësues të ekonomisë, problemi kryesor që duhet t'i japim përgjigje me punën tonë mund të përmbliidhet sikurse problemi themelor ekonomik në tri pyetjet e poshtëshënuara:

1. Çfarë duhet të ndryshojmë... m/në punë tonë?

Të ndryshosh, të gjithë e dimë që do të thotë:

- ☞ të vlerësosh të tashmen duke vendosur objektiva të një niveli më lartë për të ardhmen;
- ☞ të përcaktosh qartë jo vetëm se ku duhet të shkosh, por të përpiqesh ta mbërrish objektivin;
- ☞ të kapërcesh vështirësi e të përsosesh duke mësuar nga gabimet;
- ☞ të mos u ofrojmë më zgjidhje të gatshme nxënësve tanë, por t'i aftësojmë ata të përdorin një mekanizmin që i çon drejt gjetjes së zgjidhjes.

Po çfarë duhet të ndryshojmë konkretisht në punën tonë? Përpara së gjithash ndryshimi ynë duhet të synojë përsosjen e asaj çka është rezultat i punës sonë dhe që janë arrijtjet e nxënësve tanë, arrijtje të cilat janë rezultat i përmbajtjes mësimore që ne përcjellim tek ata, i metodologjive

të përdorura, teknikave dhe instrumenteve të shfrytëzuara për një mësim sa më tërheqës e efektiv. Pikërisht gjithë sa përmendim më sipër, duhet të jetë objekt ndryshimi e përsosjeje.

2. Si duhet të ndryshojmë...?

Duke kombinuar në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha ato çka janë komponentë apo faktorë bazë për një mësimdhënieje e nxënie me në qendër nxënësin. Duke shfrytëzuar ato mundësi jo të pakta digjitale që sot ekzistojnë e na e bëjnë më të lehtë procesin e mësimdhënies, dhe më tërheqës për nxënësin, procesin e nxënies.

A nuk gjejmë sot shumë më tepër teknika për të përcjellë njohurit e reja e po aq instrumente të cilat na nxjerrin nga rutina dhe bëjnë të jenë bashkëpunues e të tërhequr nga mësimi edhe ata nxënës që në kushte të tjera nuk do të shfaqnin të njëjtin interes?

Zotërimi i teknologjisë në trajtën e një telefoni smart është një suport teknologjik i madh që po të dimë ta mirëmenaxhojmë kthehet në një burim e instrument tepër efektiv nxënie. Përdorimi i programeve e pajisjeve kompjuterike, si edhe shfrytëzimi i rrjeteve sociale, janë një tjetër mundësi për ta parë teknologjinë si partnere dhe urëlidhëse me një brez që është kaq i përfshirë e i përthithës nëpërmjet teknologjisë. Le t'i përgatitim për realitetin që jetojnë e për botën që i pret jashtë mureve të shkollës. A nuk lënë në kujtesën e nxënësve më shumë gjurmë efekte video apo audio të realizuara edhe nga aparatet e tyre celulare e të komentuara në klasë lidhur me fakte apo fenomene ekonomike të hasura përditë?

A nuk janë ata shumë më të gatshëm të nxjerrin nga faqet elektronike më shumë informacione e fakte ekonomike të përditësuara dhe t'i nxitim t'i përvetësojnë e interpretojnë nën dritën e të menduarit ekonomik? A nuk do të na e bënte shumë më të lehtë gjithëpërfshirjen në një punë të organizuar në grupe apo një mini-projekt? Besoj se të gjithë jemi të mendimit se po.

3. Për kë të ndryshojmë?

Për të perspektivat e një brezi të ri që nuk i përket vetëm hapësirës gjeografike e administrative ku jeton por një shoqërie e ekonomie gjithmonë e më globale.

Për këta nxënës që në të tashmen janë të tillë dhe në të ardhmen e afërt qytetarë që:

bëjnë zgjedhjet ekonomike, përballen me kosto oportune dhe të marrin vendime të rëndësishme për jetën e tyre; duke përdorur arsyetimin ekonomik dhe konceptin e burimeve të kufizuara.

Me punën tonë kemi mundësi:

- ☞ t'i aftësojmë të fitojnë një kuptim më të mirë se si sistemet ekonomike funksionojnë duke kuptuar mekanizmat nxitëse të sistemeve të ndryshme ekonomike;
- ☞ t'i ndërgjegjësojmë se në të gjithë jemi pjesë e një ekonomie botërore dhe kjo kërkon që ata të shqyrtojnë bashkëveprimin dhe ndërvarësinë në marrëdhëniet ekonomike, që rezultojnë nga këmbimi dhe tregtia;
- ☞ t'ju zhvillojmë aftësitë e tyre për të interpretuar problematikën ekonomike në situata të reja të zhvillimit ekonomiko-shoqëror;
- ☞ t'ju kultivojmë përkushtimin e vazhdueshëm në trajtimin e çështjeve ekonomike dhe të pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e qytetarisë;
- ☞ t'i motivojmë të menduarin kritik dhe aftësinë për të ndjekur problematikën.

Le ta përmbushim misionin tonë me përkushtim e devocion duke ofruar modelin më të mirë

për ata që janë “konsumatorë të përditshëm të këtij produkti që quhet mësimdhënie e që nesër do të jenë kudo, e gjithçka - familjarë të mirë, sipërmarrës të shoqërisë së ardhme, shtetar e politikëbërës. Ky ndryshim duhet t'i dedikohet të ardhmes që sot materializohet në njohuri, shprehje e kompetenca, që është e mundur të arrihen vetëm falë dëshirës e këmbë nguljes, si edhe përmasave të ri-dimensionuara të mësimdhënies.

NDRYSHOJMË SË BASHKU...

1. Ndryshimi nis në mendjen tonë dhe rritet në klasë bashkë me dijet dhe aftësitë e nxënësve tanë.

Të ndryshojmë një praktikë mësimdhënieje nuk është e lehtë, pasi më parë duhet të ndryshojmë ne... filozofia jonë e mësimdhënies.

Tani më vendin e organizatorit dhe moderatorit herë pas here në klasë po aq mirë mund ta marrin vetë nxënësit, njohurit të vilen nga tekstet alternative, faqet elektronike të institucioneve publike (zyrtare dhe jo publike) apo subjekteve ekonomike. Po ashtu, informacionet nga burime zyrtare të bëhen objekt ilustrimi, diskutimi, argumenti apo kundërgargumenti. Duke nxitur e edukuar të nxënësi në këtë mënyrë vetëveprimin, gjykimin e pavarur e të shëndoshë, aftësinë për të marrë vendime, po aq sa të edukojmë ata të përcaktojnë objektiva të niveleve të ndryshme e të përpiqen të mbërrijnë ato. Më shumë se cilado lëndë, Ekonomia ka hapësirat dhe mundësitë të ndikojë në një formim shumëdimensional të të rinjve.

2. ...Vazhdon në marrëdhëniet Nxënës-Nxënës

Nëpërmjet nxitjes së punës në grup, mini-projekte apo projekte *Cross Curricularre*, ne mund të jemi nxitës të ndryshimeve edhe në këto marrëdhënie.

Në një punë në grup apo projekt, pyetjeve të tilla si:

Çfarë do të prezantojmë? Materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj., në kohë dhe në hapësirë?

Si do ta arrijmë këtë? Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve?

Kujt do t'i adresohen rezultatet e kësaj pune? Nxënësit që të zgjidh çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin ekonomik, ligjor, kulturor? Familjes? Shoqërisë dhe ekonomisë që ndryshojnë?

Ky proces mësimdhënie dhe nxënie krijues e evolutiv bëjnë që nxënësit të bashkëpunojnë, të mbështeten te njëri-tjetri, të besojnë te vetja, të shohin realitetin si burimin e pashtershëm të fakteve, të riformatojnë marrëdhëniet në grup, duke nxitur e promovuar frymën e bashkëpunimit e mirëkuptimit. Nëpërmjet një mënyre të tillë të mësuarit iu edukojmë gjetjen e zgjidhjeve, jo nisur nga modele të gatshme, por nga analiza e fakteve e rrethanave konkrete, falë përpjekjeve të tyre të përbashkëta.

3. Konkretizohet në formimin dhe arritjet e nxënësve që shprehjen e vet e gjejnë në marrëdhënien Nxënës-Komunitet-Realitet ekonomik.

Ndryshimet e shpejta në shoqërinë tonë gjejnë shprehje edhe në ndryshimin e pritshmërive të shoqërisë sonë nga shkolla.

Nëse deri disa vite më parë fitimi i dijeve apo shprehjeve ishin synimi i shkollave tona, sot kjo nuk është e mjaftueshme.

Të mësuarit me në qendër mësuesin e konsideronte të realizuar këtë proces në momentin që:

1. mësuesi transmetonte besnikërisht tekstin nga njëri vit në tjetrin;

2. nxënësit ishin në gjendje të përvetësonin këto koncepte duke e quajtur të përmbushur misionin e duke e konsideruar të mësuarit rezultat.

Por, a është sot e mjaftueshme kjo dhe a është kjo që ne kërkojmë nga vetja dhe e ardhmja jonë? Besoj se të gjithë jemi të mendimit se duke vendosur nxënësin në qendër të procesit të të mësuarit ne arrijmë të edukojmë tek ata:

- ☞ si të kuptojmë fakte e shprehi të realitetit ekonomik;
- ☞ si të interpretojnë këto fakte;
- ☞ si të argumentojnë apo kundërshtojnë nën dritën e dijeve, por edhe të një gjykimi të pavarur;
- ☞ si të mbajnë qëndrim korrekt e konsekuent për çështje që bëjnë të ndjeshëm komunitetin ku jetojmë ose më gjerë, mbarë shoqërinë;
- ☞ si t'i nxisin nxënësit të arsyetojnë e implementojnë modele të ndryshme zgjidhjesh në të mirë të shoqërisë;
- ☞ si të mendojnë në mënyrë krijuese e me besimin se gjithsecili prej tyre mund të jetë një qytetar i kënaqur nga zgjedhjet e veta, një sipërmarrës i suksesshëm apo një politikëbërës i suksesshëm.

Shkenca e ekonomisë si një disiplinë që pasqyrojnë marrëdhëniet ekonomike që krijojmë me njërin-tjetrin si agjent ekonomik, synon të analizojë e të na nxitë drejt optimizimit të zgjedhjeve tona, sikurse minimizimit të kostove oportune të këtyre zgjedhjeve. Kjo shkencë na mëson që asnjëherë të mos ngelemi të kënaqur nëse rezultati i punës sonë është vetëm dije, apo vetëm shprehje. Arritja jonë duhet të synojë qëndrime aktive e proaktive.

Shkolla e sotme ofrojnë mundësinë që nëpërmjet kësaj lënde produkti të mos jetë thjeshtë të mësuarit e koncepteve shprehive apo ligjësi, por të menduarit ekonomik e të vepruarit bazuar në analizën e fenomeneve.

Në të njëjtën filozofi, përmbajtja e lëndës së Ekonomisë bazohet në trajtimin në mënyrë sa më të kuptueshme të koncepteve, fenomeneve, e ligjësi ekonomike, po aq sa në ilustrimet me praktika e shembuj nga realiteti ekonomik. Një ndërtim i tillë krijon hapësira për të diskutuar, provuar dijet ose demonstruar aftësi interpretative dhe argumentuese lidhur me çështje të alternative, ashtu sikurse krijon hapësira për të gjetur zgjidhje e bërë zgjedhje që janë atribut i vlerave të cilat do prej nesh në shoqëri si konsumatorë, sipërmarrës apo përfaqësues të shtetit.

Brenda këtij libri do të gjeni përpjekje për të ofruar një seri mësimesh model të cilat padyshim nuk janë receta të gatshme, por vetëm një model i cili mund të përdoret përgjatë procesit të mësimdhënies, sikurse mund të ndryshohet e pasurohet nga eksperiencat e integrimi i të tjera ideve tuaja. Synimi ynë në këtë përpjekje tenton nxitjen e të menduarit kritik, çka do të thotë të integrojmë idetë në mënyrë krijuese dhe të rimodelojmë mësimin ditë pas dite. Të mos harrojmë se sipas teorisë së të mësuarit të quajtur **Honey&Mumford** ka 4 lloje të të mësuarit e po kaq nxënës tip që i hasim çdo ditë e orë në punën tonë. Sipas kësaj teorie studentët/nxënësit mund të jenë: **Aktiv, Reflektues, Teorik, Pragmatist.**

☞ **Aktiv**

Një nxënës aktiv nga një situatë e re shkon drejt një eksperimentimi konkret.

☞ **Reflektues**

Ai nxënës që nga një vëzhgimi konkret dhe eksperimentimit shkon drejt reflektimit.

☞ **Teorik**

Një nxënës i tillë nga një vëzhgim dhe reflektim shkon drejt koncepteve abstrakte dhe konkluzioneve.

☞ **Pragmatist**

Një nxënës që nga konkluzionet dhe konceptet abstrakte shkon drejt një eksperimenti aktiv.

A nuk janë të gjitha këto kategori nxënësish përballë nesh në të përditshmen tonë. Me përpjekjet tona të vazhdueshme duhet t'i nxisim këto kategori nxënësish të jenë vëzhgues të kujdesshëm të realitetit, hulumtues të këtij realiteti, si dhe kritik të asaj çka nuk është ashtu sikurse ata do të dëshironin. Njohuritë ekonomisë, ligjësitë, fenomenet, ne mund t'i ndeshim në çdo moment të jetës. Ato janë realiteti i konvertuar në çdo moment në situata ku ne gjejmë veten.

Metodologji

Të rriturit mësojnë në mënyra të ndryshme. Një shumëllojshmëri formash dhe metodat të mësimdhënies duhet të përdoren për të lehtësuar procesin e të mësuarit. Nxënësit duhet të jenë të angazhuar në procesin e të mësuarit e ne si mësues duhet të ofrojnë mundësi të planifikuara me kujdes për të zgjeruar njohuritë e nxënësve dhe aftësive.

Metodat e zakonshme që hasen sot në orët tona janë:

1. Komunikimi i njëanshëm

Leksion

Prezantim nga specialist të fushës (ekonomisë)

2. Komunikimi interaktiv i dyanshëm

Zgjidhja e problemeve kalon nëpër këto etapa:

Përcaktim i problemit, identifikimin i zgjidhjeve, hulumtim i të dhënave për të zgjidhur problemin, formulimi dhe testimi i zgjidhjeve të mundshme, falë:

- *Diskutimit;*
- *Rasteve Studimore;*
- *Lojës me role;*
- *Stuhisë së mendimeve (Brainstorming).*

3. Zhvillimin e aftësive nëpërmjet aplikimit të njohurive

- Demonstrime.
- Vizita në biznes.

Përzgjedhja e metodave të përshtatshme për një orë mësimi sa më efektive, duhet të marrë në konsideratë këta faktorë:

Objektivat - rezultatet e të nxënit
 Lëndën - përmbajtja e saj
 Pajisjet, dhe burimet që ne zotërojmë ose jo.
 Karakteristikat e nxënësve dhe prejardhjen e tyre.
 Nivelin e dëshiruar të bashkëveprimit
 Koha në dispozicion
 Mjedisit në të cilin mësohet.

Disa nga metodat që ndeshen gjatë procesit të mësimdhënies janë paraqitur shkurtimit më poshtë:

I. Stuhi e mendimeve

Detyra e çdo mësuesi është të nxitë gjithëpërfshirjen në klasë si edhe të stimulojë mendimin dhe qëndrimet e pavarura të nxënësve. Etimologjia e kësaj fjale rrjedh nga gjuha angleze e do të thotë “stuhi mendimesh” ose “arsyetim stuhi”. *Brainstorming*-u është një veprimtari që shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda dhe teknika të reja. Qëllimi i përdorimit të *brainstorming*-ut është të evidentojë sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Në momentin që ne zgjedhim këtë metodë ka shumë rëndësi:

- koha e shkurtër e zhvillimit të tij, 5-10 minuta;
- sasia e zgjidhjeve;
- çështja që trajtohet.

Janë këto elemente që i japin kuptim edhe emërtimit “Stuhi e mendimit” - “*Brainstorming*”. Detyra jonë si mësues është të nxisim mendimin e lirë dhe krijues të nxënësve. *Brainstorming*-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish, dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjëra dhe një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. Në një temë ku ne zgjedhim këtë metodologji nuk mund të lejojmë më të ketë diskutime dhe komente. Në këtë mënyrë krijojmë klimë mirëbesimi e mirëpritje për të gjithë idetë e gjykimet.

Gjatë përdorimit të kësaj metodologjie çdo nxënës mund të bëjë të vetën idenë e shokut/shoqes, ta zotërojë atë, përshtatë e ta shprehë. Kjo metodë kërkon të mbahet parasysht:

- asnjë prej zgjedhjeve dhe ideve të mos kritikohet;
- të nxitën nxënësit të shprehin ide;
- diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura;
- të aktivizohet edhe nxënës të ndrojtur;
- të shërbejë si nxehje e trurit.

Përdorimi i *brainstorming* duhet të gjendet si një metodë mjaft e përdorshme sepse:

- zhvillon aftësitë pjesëmarrëse të të gjithë nxënësve;
- rrit pavarësinë e gjyimit të nxënësve;
- inkurajon nxënësit të shprehin atë që dinë;
- jepen zgjidhje të parashikuara;
- sugjeron arsyen për të vazhduar diskutime në forma të tjera;

- zbulon preferencat e nxënësve;
- kërkon burime të pakta dhe të thjeshta.

Brainstorming nuk mund të zhvillohet:

- kur nxënësit nuk kanë njohuri për çështjen që shtrohet;
- kur çështja kyç që ju përdorni për të nuk është formuluar mirë (saktë);
- kur çështja (pyetja) kyç që ju përdorni, ka pak alternativa për zgjidhjen e problemit.

II. Harta e të pyeturit

Kjo është sot një teknikë mjaft bashkëkohore e të pyeturit që gjen hapësirën e duhur në mësimin e Ekonomisë.

Kjo metodologji është një skicë që shfaq ide të rëndësishme të mësimin, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit.

Përparësitë e përdorimi të kësaj metodologjie janë:

- hap rrugën për diskutim;
- ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi për të menduar e reflektuar;
- tërheq nxënësit në punë të pavarur;
- nxit përfshirjen e nxënësve në mësim;
- nxit të menduarin logjik;
- nxit dhe tërheq nxënësit pasiv.


Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit.

Ajo mund të përdoret gjithashtu, gjatë një mësimi për të nxitur diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të sintetizuar informacionin e trajtuar.

- Si të krijojmë një hartë të pyeturi?

Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- shkruhet tema e mësimin që do të shpjegohet në qendër të tabelës;
- vizatohet harta e të pyeturit në të cilën pas pyetjeve kyç gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën;
- formulohen nënpyetje me të cilat aktivizohen nxënësit pasivë.



III . Përshkrimi me terma të përfaqëta

Parashikimi me terma paraprakë është një teknikë evokuese dhe reflektuese, e cila i nxit krijuesit të krijojnë një histori, të përcaktojnë rezultatet e një demonstrimi, të përshkruajnë një dukuri, duke u bazuar në katër termat e dhënë paraprakisht. Kjo veprimtari e thjeshtë, i fut nxënësit në mendime dhe i motivon për të qenë të vëmendshëm gjatë leximit të mëvonshëm të tekstit, gjatë analizës së rasteve studimore etj.

“Përshkrimi me terma të përfaqëta” përdoret në fazën e evokimit. Zgjedhja e temës ka rëndësi kështu, zgjidhen ato tema në të cilat, nxënësit duke i kombinuar të dhënat mund të krijojnë diçka ose mund të japin një produkt apo rezultat. Si veprimtari zgjat 5-10 minuta.

Teknika i nxit nxënësit të jenë dëgjues të vëmendshëm, u nxit kureshtjen dhe dëshirën për të lexuar me kujdes pasi kanë bërë përpjekje të evidentojnë çfarë dinë lidhur me konceptet e përmendur, i nxit për të reflektuar mbi atë çka kanë menduar, rrit vetëbesimin e tyre.


Ju revokon njohuri të cilat megjithëse në mënyrë jo mirë të konsoliduara janë tashmë në mendjen e tyre falë realitetit ekonomik që përjetojmë çdo ditë.

Si mund ta aplikojmë atë?

Për të aplikuar një metodologji si kjo, cilido prej nesh, para se të japë njohuritë e reja, shkruan në tabelë një numër termash kryesorë (të cilët mund të jenë koncepte) nga tema e re dhe që nxitin nxënësit: - të evidentojnë çka dinë apo mendojnë rreth këtyre termave. Nxënësit shkruajnë në një letra me tri ngjyra variantin e tyre dhe i vendosin në një tabelë, duke i grupuar sipas ngjashmërisë së ideve. Mësuesi grupon përgjigjet e nxënësve në tabelë. Mbajtja e shënimeve nga ana e mësuesit është një element i rëndësishëm, pasi nxënësit kuptojnë se puna që kryejnë kërkon seriozitet dhe do të dëgjohet më vëmendje nga shokët dhe mësuesi.

Shembull:

- Jepen termat: Konkurrencë e plotë, Konkurrencë monopolistike, Oligopol dhe Monopol
- Nxënësit do të formojnë me shkrim, individualisht, nga një përcaktim për çdo term por që të kenë lidhje midis tyre.
- Mësuesi grupon përgjigjet shumë të ngjashme.



IV. VEPRIMTARIA E TË MENDUARIT DHE TË LEXUARIT TË DREJTUAR-DRTA

Veprimtaria e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar, DRTA, është një tjetër veprimtari, gjatë së cilës nxiten të mendojnë e të parashikojnë rreth asaj që hasin përgjatë një leximi apo rasti studimor duke evidentuar ato që i mendojnë si më esenciale. Kjo metodë mund të jetë një gjetje e mirë në trajtimin e të fenomeneve ekonomike: *papunësi, inflacion* etj.

Për të përdorur këtë metodë, ndërtojmë një tabelë në të cilën pyetjet janë: “Papunësia”.

Për çfarë mendoni se bën fjalë kjo temë?	Pse mendoni kështu?	Refleksione pas Leximit?

Për të plotësuar këtë tabelë, mësuesi bën pyetje të cilat, orientojnë vëmendjen e nxënësit në titujt ose ilustrimet e zgjedhura (Artikuj të botuar në median e shkruar apo atë elektronike janë një burim i mirë për t’u analizuar dhe arritur në konceptet kyç). Mësimi mund të filloj me një diskutim për titullin e temës dhe duke u bazuar në pyetjet: *Për çfarë mendoni se mund të bëj fjalë kjo temë? Pse mendoni kështu?* Parashikimet shkruhen në ndarjen e parë të tabelës ose në tabelë. Mësuesi mund të pranoj të gjitha parashikimet e bëra nga ana e nxënësve. Pas këtyre diskutimeve fillestare, nxënësit do të lexojnë në heshtje tekstin deri në momentet e përcaktuara që më parë nga mësuesi, për të nxjerrë pikat apo provat që tregojnë nëse parashikimet e tyre janë të sakta apo jo?

Në këtë pikë, diskutimi vazhdon në parashikime të tjera të dhëna nga nxënësit, bazuar në leximin/rastin studimor të tyre deri në këtë fazë. Këto veprime përsëriten derisa historia apo teksti i dhënë të mbaroj.

Reflektimi.

Disa pyetje kryesore që mund të bëhen pas leximit janë:

Në çfarë fokusohet ky lexim apo rast studimor?

Cili është problemi që trajtohet? Përse mendoni kështu?

Po tani cili është mendimi juaj?

Ç'mendoni rreth zgjidhjes që ka ky fenomen?

Çfarë do të mendonit po të ishit në vend politikëbërës?

Po tani në fund që problem u zgjidh, çfarë mendoni?

Aktiviteti i të menduarit e të lexuarit të drejtuar (DRITA) mund të përdoret mjaft mirë në fazën e realizimit të kuptimit. I zgjedhur si metodë në tema në të cilat ka në qendër një problematikë të fort, që ndryshon papritur rrjedhën. Kohëzgjatja ndryshon nga 20-25 minuta. Përdorimi i kësaj teknike nxit kuriozitetin e nxënësve deri në fund të zbulimit të përmbajtjes e argumentit të pjesës. Nxënësit i kryejnë disa procese gjatë kësaj faze. Ata lexojnë me vëmendje leximin/Rastin Studimor dhe nxjerrin provat mbështetëse të paragrafit që lexojnë dhe parashikojnë se ç'mund të ndodh më tej. Kjo veprimtari mund të pasojë punën e bërë në fazën e evokimit.

Planifikimi i kurrikulës për klasën XII

Fusha: Ekonomia dhe Mjedisi

LËNDA: Ekonomi

MËSUESI: _____

Planifikimi përmban: Planin Vjetor; Planet sipas tremujorëve
Modele të planifikimit ditor

PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA XI

FUSHA: Shoqëria dhe Mjedisi

LËNDA: Ekonomi

Tematikat	Shtator – Dhjetor 25 orë	Shpërndarja e përmbajtjes tëndore për realizimin e kompetencave	Prill - Qershor 20 orë
Ekonomia e tregut	Çfarë studion ekonomia . (6 ore) 5 Teori+ 1 Veprimtari praktike	Prodhimi , kostoja dhe të ardhurat e firmes. (5 orë) 3 Teori + 1 Veprimtari praktike +1 Ushtrime .	
Ekonomia tregut	Kërkesa oferta dhe cmimi I tregut. (9 orë) 7 Teori + 1 Njohuri përmbledhëse +1 Ushtrime	Strukturat e tregut (6 orë) 5 Teori + 1 Njohuri përmbledhëse	
Ekonomia tregut	Konsumatori ne ekonominë e tregut. (3 orë) 2 Teori + 1 Veprimtari praktike /ushtrime)	Tregjet e faktorëve të prodhimit (5 orë) 4 orë Teori orë +1 orë Projekt	
Ekonomia tregut	Fillimi i një biznesi dhe financimi I tij. (7 orë) 5 teori + 1 Njohuri përmbledhëse +1 Test		
Ekonomia kombëtare			

Ekonomia kombëtare		Qeveria dhe ekonomia (7 orë) 5 Teori + 1 Njohuri përmbledhëse + 1 Test	Paraja dhe Institucionet financiare (4 ore) , 4 Teori	
Ekonomia kombëtare			Treguesit kryesor makroekonomik 8 orë	
Ekonomia kombëtare			6 Teori + 1 Veprimtari praktike + 1 Njohuri përmbledhëse Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike (3 orë) 3 orë Teori	
Ekonomia globale			Tregtia ndërkombëtare 5 orë 4 Teori + 1 Test + 1 Projekt.	

PLANIFIKIMI 3 – MUJOR (SHTATOR – DHJETOR)

FUSHA: Shoqëria dhe Mjedisi

LËNDA: Ekonomi

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca qytetare ; demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpëton ato në një debat me të tjerët.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit ; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar.

Kompetenca e të menduarit ; krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, që kërkon zgjidhje ekonomike si dhe prezanton procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve; modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë për një temë të caktuar nga ekonomia , duke dhënë sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur.

Kompetenca e të nxënit : demonstroi shkallësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbledhjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.

Kompetenca për jetën ; sipërmarrjen dhe mjedisin ,demonstroi pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të pëditshmërisë ,initiativave sipërmarrëse dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kompetenca personale : gjykon në mënyrë të komunikimit, të sjelljeve dhe të qëndrimeve që nxisin konflikte ndërpersonale në klasë, në shkollë apo në shoqëri dhe jep shembuj të menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërpersonale në mënyrë konstruktive

Kompetenca digjitale ;demonstroi aftësi në dokumentimin kronologjik ,të ndryshueshëm dhe në vazhdimësi të fakteve dhe procedurave ekonomike .

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave

Zgjidhja probleme: modelon dhe zgjidh situata probleme, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë; përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera.;

Arsyetimi dhe vërtetimi ekonomik: gjykon në vërtetësinë e një rezultati të dhënë i cili mund të jetë gjetur me llogaritje; përdor drejt disa rregulla elementare të logjikës e të arsyesimit ekonomik korrekt.

Të menduarit dhe komunikimi ekonomik : demonstroi zbatimin e veprimeve dhe iniciativave ekonomike ; merr informacion dhe jep informacion nga baza të dhënash.

Lidhja konceptuale: integron njohuritë e shprehjetë ekonomike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.); Modelimi ekonomik: krijon modele që përmbajnë konceptet bazë ekonomike si: kërkesë, ofertë, tregje, etj.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënërit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve	Vlerësimi	Burimet	
1	Çfarë studion ekonomia (6 ore) 5 Teori + 1 Veprimtari praktike	Panjafuqshmëria, zgjedhja dhe kosto oportune	<i>Për çfarë na shërben ekonomia</i>	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Vlerësim diagnostikues	Teksti i ekonomisë për klasën e XI; Libër ushtrimesh XI;	
2		Burimet dhe kufiri i mundësive të prodhimit					
3		Problemi ekonomik themelor dhe rëndësia ekonomisë si shkencë	<i>Lëvizja e akrepave të orës.</i>	Puna në grup dhe puna individuale;	<ul style="list-style-type: none"> • intervistë me një listë treguesish; • vetëvlerësim me listëkontrolli; 	Teksti i mësuësit për klasën e XI;	
4		Problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike.					
5		Shtyllat e Sipërmarrjes së lirë	<i>Njësitë e përdorimit të kompjuterave.</i>				
6	Veprimtari praktike : Të dhënat ekonomike mblodhja dhe interpretimi Në funksion të Projektit			Hetimi dhe zbulimi;		Materiale nga interneti;	
7	Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut (9 orë) 7 Teori + 1 Njohuri përmbledhëse + 1 Ushtrime	Kërkesa dhe lakorja e kërkesës	<i>Përdorimi i numrave irracionale në gjeometri</i>	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)		
8		Elasticitet i kërkesës	<i>(Përsëritje) Vetëvlerësim i nxënësit</i>	Metoda integrale	<ul style="list-style-type: none"> • vlerësimi i përgjigjeve me gojë; • vlerësimi i punës në grup; • vlerësim mes 		
9		Oferta dhe lakorja e ofertës		<i>Ushtrime dhe situata problemore nga jeta reale</i>			
10		Elasticiteti i ofertës		<i>Për çfarë na shërben ekonomia?</i>	Bashkëbisedim		
11		Ekuilibri i tregu		Dejyrë krijuese	Teknika që		

12		Kontrolli i çmimeve dhe forcat e tregut			zhvillojnë mendimin kritik dhe krijuen Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK	nxënësisht; <ul style="list-style-type: none"> vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular 	
13		Bashkëpunimi midis tregjeve (të mirat zëvendësuese /plotësuese dhe kërkesa e derivuar					
14		Njohuri përmbledhëse Ekonomiksi aplikuar .Kërkesa ,Oferta ,Tregu	Përdorimi i TIK për ndërtimin e grafiqëve		Projekte kurrikulare Konkurse		
15		Ushtrime /Elasticitetit i kërkesës dhe ofertës)					
16	Konsumatori në Ekonominë e Tregut	Konsumator dhe kursyes		<i>Të ardhurat e një familje</i>			
17		Buxheti Vetjak					
18	(3 orë) 2 Teori + 1 Projekt	Projekt Faza I Përcaktim i temës /grupeve . 1"Kërkesa për produktet					

PLANIFIKIMI 3 – MUJOR (JANAR – MARS)

FUSHA: Shoqëria dhe Mjedisi

LËNDA: Ekonomi

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme..</p> <p>Kompetenca për jetën, sipër-marrjen dhe mjedisin: demonstroi shprehje organizative në punët individuale dhe në ekip përmes situatave reale në detyrat e veçanta mësimore, duke menaxhuar potencialin individual dhe atë të grupit, si dhe kohën, risqet dhe buxhetin në dispozicion.</p> <p>Kompetenca digjitale: përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet vizualizimeve të filmuara apo të animuara</p>	<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave ekonomike</p> <p>Zgjidhja probleme: përdor simbolet koncepte kyç , dhe ligjet e kërkesës dhe ofertës për të përshkruar situata praktike.</p> <p>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: përdor arsyetimin, krasimin ose parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një problemi ekonomik brenda njohurive të mësuara; pyet dëndur “pse” veten dhe të tjerët për të përligjur një përfundim.</p> <p>Të menduarit dhe komunikimi ekonomik : përshkruan, shpjegon dhe diskuton me gojë dhe me shkrim, veprimtaritë praktike, hamendjet dhe procesin e zgjidhjes.</p> <p>Lidhja konceptuale: bën lidhje ndërmjet koncepteve të tregjeve</p> <p>Modelimi ekonomik : krijon modele që përmbajnë konceptet bazë në ekonomin e tregut dhe atë kombëtare</p> <p>Përdorimi i teknologjisë në matematikë: zgjidh detyra të ekonomiksit duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe të TIK-ut.</p>
---	--

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashkuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
26	Prodhimi, kostoja dhe tëardhurat e firmës. (5 orë) 3 Teori + 1 Veprimtari praktike +1 Ushtrime	Prodhimi dhe funksioni i prodhimit	<i>Vëllimi i shpenzimeve të Coca –Cola Al</i>			
27		Të ardhurat dhe kategoritë e kostos				
28		Lakoret e kostos ne përtudhën afatshkurtër				
29		Veprimtari praktike: Llogaritja e kostove të prodhimit për produktet e prodhuara nga kompania e nxënësve të shkollës	<i>Trofeu i një çmimi</i>			
30		Ushtrime: Treguesit e prodhimit .	<i>(Përsëritje)</i> <i>Vlerësim i nxënësve nga nxënësi-mësuesi</i>			
31		Thelbi i konkurrencës				
32	Struktura e tregut tregut (6 orë) 5 Teori +1 Njohuri përmbledhëse	Struktura e tregut në konkurrencë të plotë				
33		Analiza ekonomike e firmës në konkurrencë të plotë në afat të shkurtër				
34		Struktura e tregut Monopol				
35		Konkurrenca Monopolistike dhe Oligopoli				
36		Njohuri përmbledhëse " Strukturat e tregut "				
37	Tregjet e faktorëve të prodhimit(5 orë) 4 orë Teori +1 orë Projekt	Puna si faktor kryesor i procesit të prodhimit				
38		Oferta e punës dhe ekuilibri në tregun e punës				
39		Toka si Faktor kryesor prodhimi)				
40		Kapitali , Faktor kryesor prodhimi				
41		Projekt :Faza II Te dhënat e				

			mbledhura					
42			Roli i qeverisë arbitër në ekonominë e tregut)					
43			Roli i qeverisë si menaxher e pjesëmarrës në ekonominë e tregut					
44			Roli i qeverisë në ekonomi në këndvështrime të ndryshme ekonomike.					
45			Roli i qeverisë në ekonomi dhe buxheti. Taksat					
46			Defiçiti buxhetor dhe borxhi publik					
47			Njohuri përmbledhëse					
48			Test Përmbledhës					

PLANIFIKIMI 3 – MUJOR (PRILL – QERSHOR)

FUSHA: Shoqëria dhe Mjedisi

LËNDA: Ekonomi

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një esse nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit: gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh., rezultatit e një detyre nga ekonomia etj.) i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykimit të dhënë.

Kompetenca e të nxënësve: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: harton-ri shikon një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përpulje me rezultatet e pritshme.

Kompetenca digjitale: gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediatash

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave matematikore

Zgjidhja probleme: përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera.

Arsyetimi dhe vërtetimi ekonomik : përdor arsyetimin, veprimet me mend ose parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një problemi/situatë ekonomike.

Të menduarit dhe komunikimi ekonomik : merr dhe jep informacion nga baza të ndryshme të të dhënave .

Lidhja konceptuale: integron njohuritë e shprehitë ekonomike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).

Modelimi ekonomik : krijon modele që përmbajnë konceptet bazë në mikro apo makroekonomike .; përdor disa shkathësi argumentuese lidhur me modelimin dhe zbatimin e modeleve .

Përdorimi i teknologjisë në ekonomi : zgjidh detyra ekonomike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e TIK-ut.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënërit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
49	Paraja dhe institucionet financiare (4 ore), 4 Teori	Paraja dhe funksionet e saj				
50		Format e parasë dhe oferta e parasë				
51		Bankat tregtare dhe roli i tyre si ndërmjetës financiar				
52		Sistemi bankar në Shqipëri				
53	Treguesit kryesorë makroekonomikë 8 orë (6 Teori + 1 Veprimtari praktike + 1 Njohuri përmbledhëse)	Treguesit makro-ekonomik dhe produkti total i ekonomisë.				
54		Tipare të tjera të GDP-së dhe metodat e matjes së saj.				
55		Papunësia				
56		Inflacioni				
57		Kostot e papunësisë dhe të inflacionit				
58		Ciklet e biznesit				
59		Veprimtari praktike :Treguesit makroekonomik mbledhja dhe interpretimi.				
60		Njohuri përmbledhëse				
61	Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomikë (3 orë) 3 orë Teori	Stabilizimi ekonomik dhe politikat publike				
62		Politika monetare				
63		Kritika per politikën monetare dhe fiskale				
64		Tregëtia ndërkombëtare 5 orë	Shkaqet e tregtisë midis vendeve . Përpalesite absolute dhe përparësite krahasuese			
65	(4 Teori +1 Test + 1 Projekt .)	Tregtia e lirë dhe proteksionizmi				
66		Kurset e këmbimit valutor dhe tregtia				
67		Test Përfundimtar				
68		Projekt faza mbyllëse				

MODEL PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda:	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore:		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave matematikore sipas temës mësimore: Nxënësi në fund të orës së mësimit:		Fjalët kyçe:	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit: Parashikimi i njohurive: Ndërtimi i njohurive: Përforcimi i të nxënit:			
Vlerësimi:			
Detyra:			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Ekonomia si shkencë e zgjedhjes optimale		Situata e të nxënimit: Zgjedhja optimale	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: demonstroi shkathhtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: - përkufizon objektin e ekonomisë; - përkufizon konceptet: pamjaftueshmëria, zgjedhja dhe kostoja oportune.		Objekti i ekonomisë Pamjaftueshmëria Zgjedhja Kostoja oportune	
Burimet: CD / DVD / USB, <i>Power point</i> , video-projektor, internet,		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve – Brainstorming-Shpjegim-Reflektim			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
<p>Tema hyrëse e lëndës së Ekonomisë vjen si një prezantim i disa koncepteve, të cilat janë të rëndësishme për studimin e ekonomisë. Në këtë fazë të parë të orës mësimore do të sjellim në vëmendjen e nxënësve disa sjelle individuale, të cilat edhe ata vetë në ndërveprimin e përditshëm i realizojnë. Së pari, duke zgjuar vëmendjen e tyre shtrojmë pyetje të tilla si:</p> <p>Nëse do t'ju jepej mundësia, a do të blini produkte me teknologjinë e fundit?</p> <p>Përse ndodh që kjo dëshirë e juaja të mos realizohet?</p> <p>Nëse do t'ju kërkohej të përzgjidhnit ndërmjet qëndrimit në një orë mësimore dhe qëndrimit në një bar-caffë, çfarë do të zgjidhnit? Çfarë do të merrnit në konsideratë kur të bëni zgjedhjen tuaj?</p>			

REALIZIMI (Shpjegim)

Pasi nxënësve u është kërkuar mendimi i tyre në lidhje me pyetjet e mësipërme, u bëhet lidhja me konceptet bazike. Mësuesi/ja në këtë moment nëpërmjet shpjegimit, sqaron konceptet:

- e pamjaftueshmërisë;
- e zgjedhjes;
- e kostos oportune;
- zgjedhjes optimale.

REFLEKTIMI (Shkrim i lirë)

Pasi janë shpjeguar termat themelore, nxënësve u kërkohet që duke u nisur nga ato që trajtuam në një punim të shkurtër, të përshkruajnë një ditë të tyre të përditshme, në të cilën ata përballen me konceptet e zhvilluara.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Diskutim: Si kanë ndryshuar nevojat e familjeve gjatë viteve të tranzicionit. A janë rritur ato? Çfarë faktorësh mendoni se kanë ndikuar?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___


Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Burimet prodhuese		Situata e të nxënit: Shqipëria burimet natyrore dhe ato njerëzore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar. Kompetenca e të nxënit: demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - identifikon burimet prodhuese; - identifikon kufirin e mundësive të prodhimit; - analizon burimet prodhuese dhe kufirin e mundësive të prodhimit.		Fjalët kyçe: Burimet prodhuese Burimet natyrore Burimet njerëzore Kapitali Aftësia sipërmarrëse Kufiri i mundësive të prodhimit	
Burimet: Libri, <i>Power point</i> , video-projektor, <i>Flip---</i> <i>charter</i> etj..		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster – Diskutim - Punë me shkrim			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (Kllaster) Ekonomizimi i burimeve për arritjen e një qëllimi do të jetë çështja që do të ndjekim gjatë zhvillimit të kësaj lënde. Në këtë fazë të parë të mësimi, nëpërmjet një kllasteri paraqesim:			
<pre> graph TD A([BURIMET NATYRORE]) --> D([AFTËSIA SIPËRMARRËSE]) B([BURIMET NJERËZORE]) --> D C([KAPITALI]) --> D D --> E([BURIME PRODHUESE]) </pre>			

BURIME PRODHUESE

Pasi bëjmë këtë paraqitje, nxënit të tentojnë të kenë një perceptim të tyre mbi këto terma.

REALIZIMI I KUPTIMIT (Diskutim)

Pasi realizuam sqarimin e termave të mësipërme, nxënësve u shtrohet për diskutim pyetja:



Në varësi të argumenteve, nxënësit i japin përgjigje dhe pyetjes së dytë:

- Nga çfarë do të ndikohej niveli i përzgjedhur?

Kjo fazë mbyllet me një shpjegim për konceptin e kufirit të mundësisë së prodhimit (KMP).

REFLEKTIMI(Punë me shkrim)

Për minutat në vazhdim, nxënësve u jepet një ushtrim, si për shembull:

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa alternativa të përdorimit të burimeve

Kombinimi i prodhimit	Veshje (mijë njësi)	Grurë (mijë tonë)
A	0	35
B	50	30
C	75	20
D	90	10
E	95	0

- Ndërtoni grafikun e kufirit të mundësive të prodhimit.
- Cila është kostoja oportune e kalimit nga kombinimi B te D?
- Po nga kombinimi i D tek E?
- Ç'prirje vihet re për koston oportune të prodhimit të veshjeve?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me perceptimin e burimeve të prodhimit;
- për argumentimin e përgjigjeve në lidhje me pyetjen e shtruar për diskutim;
- për përmbylljen e kërkesave të ushtrimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Shkenca e ekonomisë		Situata e të nxënit: Burimet ekonomike në familje	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre; bën përmbledhjen e politikave të përdorura.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon problemin themelor të ekonomisë; - përkufizon termat <i>mikroekonomi</i> dhe <i>makroekonomi</i>; - bën dallimin midis mikroekonomisë dhe makroekonomisë; - përcakton dhe analizon se si zgjidhet problemi ekonomik themelor. 		Fjalët kyçe: Problemi ekonomik themelor Shkenca e ekonomisë Mikroekonomia Makroekonomia	
Burimet: Libri i nxënësit , interneti, <i>Power point</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		Kllaster - Shpjegim - Shkrim i lirë	
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (Kllaster) Në këtë orë mësimi do të trajtohet një çështje me interes të madh në ekonomi, e cila ka të bëjë me problemin ekonomik themelor. Për të trajtuar problemin themelor ekonomik, klasa ndahet në tri grupe dhe secili grup plotëson një kllaster (pra ndërtohen tri kllastera) me anë të ideve të tij.			
Problemi themelor ekonomik			
<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;">Çfarë të prodhohet ?</div>		<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;">Si të prodhohet ?</div>	
<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;">Për kë të prodhohet ?</div>			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Pasi paraqitet problemi ekonomik themelor, do të shpjegohet se cilat janë dy degët e ekonomisë, që u japin përgjigje tri çështjeve kryesore apo tri përmasave të problemit ekonomik themelor:

Mikroekonomia



Studion sjelljen individuale

Makroekonomia



Studion sjelljen e ekonomisë

REFLEKTIMI (Shkrim i lirë)

Gjatë minutave të mbetura, nxënësve u kërkohet të hedhin në letër mendimin e tyre në lidhje me pyetjen: “A mendoni se ndihmoni me veprimtarinë tuaj të përditshme për zgjidhjen e problemit ekonomik themelor të shoqërisë sonë? Pse?”

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna;
- për arsyetimet e dhëna gjatë pyetjeve analitike;
- për arsyetimin e dhënë gjatë diskutimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Si do t'i përgjigjeshit problemit ekonomik themelor, duke e parë veten në të ardhmen si: individ/ firmë/ përfaqësues i qeverisë?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Sistemet ekonomike		Situata e të nxënit: Ekonomia e tregut vs Ekonomia e përzier	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit ; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar.</p> <p>Kompetenca e të nxënit:: demonstroi shkathhtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtroi pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -rendit tipet kryesore të sistemeve ekonomike -përkufizon dhe interpreton sistemet kryesore ekonomike -përshkruan qëllimet e përgjithshme shoqërore. -evidenton dallimet ndërmjet sistemeve nga shkalla e plotësimit të kriterëve		Fjalët kyçe: Ekonomia tradicionale Ekonomia e komanduar Ekonomi tregu Qëllime të përgjithshme shoqërore Liria ekonomike Eficiencia ekonomike Barazia ekonomike Siguria ekonomike Rritja ekonomike	
Burimet: Libri, internet, tabela e zezë, video-projektor, <i>Flip---charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kllaster- Shpjegim- Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (Kllaster) Kjo fazë fillon me një kllaster me konceptin: sistemet ekonomike . Më pas pyeten nxënësit: Keni dëgjuar për sistemet ekonomike? Duke marrë në konsideratë njohuritë dhe përgjigjet e tyre, për të plotësuar kllasterin vijon pyetja e dytë: Cilat janë tipat që ju keni dëgjuar? - dhe kllasteri merr pamjen e mëposhtme			
<div style="display: flex; align-items: center; justify-content: center;"> <div style="margin-right: 20px;"> <p>Ekonomia tradicionale</p> <p>Ekonomia e komanduar</p> <p>Ekonomia e tregut</p> </div> </div>			

REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)

Pasi evidentohen tipat e sistemeve ekonomike nëpërmjet shpjegimit u tregohet nxënësve se:

- Cilat janë qëllimet (kriteret e përgjithshme ekonomike)
- Sa janë sistemet ekonomike të afta të realizojnë arritjen e këtyre qëllimeve.

Nëpërmjet shpjegimit të çështjeve të mësipërme nxënësit kanë marrë njohuritë e duhura në lidhje me funksionimin e sistemeve dhe krahasimin midis tyre.

REFLEKTIMI(Diskutim)

Në fazën e reflektimit shtrohet për diskutim pyetja:

PO		JO
┌	A ka një sistem më të mirë kundrejt të tjerëve?	┌

Dëgjoen mendimet e nxënësve dhe paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelë

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:


- për mendimet e dhëna në lidhje me plotësimin e kllasterit.
- për arsyetimet gjatë diskutimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Një nga tiparet kryesore të ekonomisë së tregut është konkurrenca. Si mendoni, në ç'raport është konkurrenca me lirinë ekonomike?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Sipërmarrja e lirë		Situata e të nxënimit: Sipërmarrje të suksesshme në komunitetin tuaj	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit ; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit:: demonstroi shkathhtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtroi pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -përcakton shtyllat kryesore të sipërmarrjes -përcakton agjentët ekonomik -analizon shtyllat kryesore të sipërmarrjes -interpretin si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve		Fjalët kyçe: Shtylla të sipërmarrjes Prona private Çmimi Konkurrenca Aftësi sipërmarrëse Agjentët ekonomik	
Burimet: Libri, tabela e zezë, video-projektor, <i>Flip---charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim me terma paraprakë - Shpjegim-Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI (Parashikim me terma paraprakë) Për të realizuar këtë orë mësimore, i rikthehem temës së kaluar, në të cilën diskutuam edhe për sistemin e ekonomisë së tregut, pra i sipërmarrjes së lirë. Këtij sistemi për të mirëfunksionuar i duhet që të mbështetet edhe në shtyllat e sipërmarrjes së lirë. Për të sjellë sa më afër ideve të sakta, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët:			
 <p>Prona private Çmimi Konkurrenca Aftësia sipërmarrëse</p>			

kërkon nga nxënësit të përshkruajnë ç'dinë për to dhe cila mund të jetë lidhja midis tyre.

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Pasi janë përcaktuar shtyllat e sipërmarrjes, mësuesi/ja duhet të shpjegoj:

- Funksionimin e ekonomisë së tregut
- Rolin e qeverisë në një ekonomi tregu

Mësuesi/ja paraqet në tabelë skemën e qarkullimit ekonomik

REFLEKTIMI (Brainstorming)

Pasi shpjegohet sipërmarrja e lirë, shtyllat e saj, roli i qeverisë shtrohet pyetja:

Në rastin kur shumë njerëz ankohen për çmime të larta në treg për një sërë mallrash krahasuar me të ardhurat e tyre, çfarë hapësirash mendoni se ka në këtë mes për ndërhyrjen e qeverisë?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike..

Detyrat dhe puna e pavarur:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Kërkesa dhe lakorja e kërkesës		Situata e të nxënit: Ndryshimi në fuqinë blerëse ndikimi në kërkesë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit; nxënësi/ja diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar.			
Kompetenca e të nxënit: nxënësi/ja demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre; bën përmbledhjen e politikave të përdorura.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Sasi e kërkuar	
- përkufizon sasinë e kërkuar, kërkesën;		Kërkesa	
- shpjegon faktorët kryesorë që ndikojnë tek kërkesa;		Nevoja, të mira normale/inferiore	
- interpreton lakoren e kërkesës;		Çmim i mallit	
- ilustron ligjin e kërkesës.		Pritje (parashikime)	
		Shije të konsumatorit	
		Lakore e kërkesës	
		Ligji i kërkesës	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve – Brainstorming - Përvijimi i të menduarit – Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Në këtë fazë merren shembuj të të mirave, të cilat ne i konsumojmë apo i përdorim në jetën e përditshme. Në varësi të së mirës shtrohen pyetjet:			
1. Nëse çmimi i asaj të mire rritet, çfarë ndodh me kërkesën?			
2. Nëse çmimi i asaj të mire rritet, kërkesa për atë produkt nuk ndryshon. (Nëse kërkesa për atë produkt nuk ndryshon, çfarë ndodh me çmimin?)			
3. Nëse të ardhurat rriten, çfarë ndodh me kërkesën për atë produkt?			
4. Të ardhurat rriten, kërkesa për këtë produkt rritet shumë më shumë sesa të ardhurat. (Nëse kërkesa për këtë produkt rritet shumë më shumë sesa të ardhurat, çfarë ndodh me të ardhurat?)			

Përgjigjet dhe argumentet e sjella nga secili grup demonstrohen në tabelë, duke theksuar se koncepti sasi e kërkuar apo kërkesë, që janë në fokus të kësaj teme, nuk janë tërësisht të panjohura. Realiteti dhe sjelljet me natyrë ekonomike na shoqërojnë në çdo moment, kështu që shumë prej përgjigjeve të nxënësve veçohen dhe përdoren në etapën tjetër duke u strukturuar e pasuruar më tej.

REALIZIMI I KUPTIMIT Përvijimi i të menduarit

Në këtë etapë, mësuesi/ja evidenton se si të gjitha rastet e përmendura në stuhinë e mendimeve janë të mundshme dhe të përligjura nga ligji i kërkesës. Kështu, për të katërta situatat e sipërpërmendura merret nga një shembull lidhur me :

1. Të mirat normale (p. sh: kufje telefoni)

Me rritjen e çmimit të një të mire, sasia e kërkuar për këtë të mirë (kufje telefoni) bie.

2. Të mirat e domosdoshme, të cilat evidentojnë se, megjithëse çmimi i një të mire rritet (medikamente mjekësore) kërkesa nuk ndryshon.

3. Të mirat inferiore, të cilat me rritjen e të ardhurave kërkohen më pak (veshje jocalësore)

4. Të mirat e luksit, të cilat me rritjen e të ardhurave, kërkesa për to rritet më shumë se rritja e të ardhurave (makinat luksoze, udhëtimet turistike).

2. REFLEKTIMI (Punë në grupe)

Mësuesi/ja i jep tabelën e mëposhtme:

Çmimi P	Sasia Q
180	1
140	2
100	4
60	10
20	20

Ndahet klasa në 4 grupe. Secili nga grupet ka për të përmbushur një detyrë dhe përkatësisht:

Grupi 1: Përpiqet të përkufizojë se çfarë ndodh me sasinë e kërkuar (Ligji i kërkesës) për një të mirë, kur çmimi i kësaj të mire rritet/ulet.

Grupi 2: Ndërton lakoren e kërkesës, bazuar në të dhënat e tabelës, dhe përpiqet të evidentojë lidhjen inverse çmim-sasi e kërkuar.

Grupi 3: Bën dallimin në paraqitjen grafike dhe si koncept midis sasisë së kërkuar dhe kërkesës (Sasia e kërkuar një pikë në lakore; Kërkesa lakorja.

Grupi 4: Ndryshimi në çmim tregon lëvizje përgjatë lakores, ndikimi i një prej faktorëve si çmimet e mallrave (zëvendësuese/plotësuese), të ardhurat apo shijet shkaktojnë zhvendosje të lakores nga e djathta apo e majta.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna gjatë Brainstorming-ut;
- për rezultatet e punëve në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Të listohen të mira apo shërbime, të cilat nuk i binden ligjit të kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Elasticiteti i kërkesës		Situata e të nxënit: Çmimi i karburanteve dhe automobilave	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj., në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij/saj.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon ç'është elasticiteti i kërkesës; - evidenton se si e matim elasticitetin e kërkesës në lidhje me çmimin, të ardhurat, çmimet e të mirave zëvendësuese dhe plotësuese; - argumenton me shembuj dhe paraqitje grafike raste të kërkesës elastike, joelastike, plotësisht elastike, plotësisht joelastike. 		<ul style="list-style-type: none"> Kërkesë elastike Kërkesë joelastike Kërkesë plotësisht elastike Kërkesë plotësisht joelastike Kërkesë me elasticitet njësi Elasticitetin e kryqëzuar 	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, <i>Power point</i> , <i>Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve – Brainstorming - Kubimi			
Organizimi i orës së mësimimit			
Evokimi (Brainstorming)			
Nëpërmjet kësaj metode kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen:			
1. Si mund ta përkufizoni me fjalët tuaja termin <i>elasticitet</i> (reagueshmëri)?			
Përkufizimet e shkruara nga secili nxënës pasqyrohen në tabelë.			
Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përkufizimet e bëra, nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në jetën e përditshme etj.			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Kubimi)

Në këtë fazë përdoret një kub, ku numrit të çdo faqeje i korrespondon dhe një detyrë.

Ndahet klasa në 6 grupe. Nga çdo grup, një përfaqësues hedh kubin, në varësi të numrit të faqes i prezantohet grupit detyra. Kjo ndodh me të gjitha grupet. Konkretisht:

Faqja 1, detyra: Përshkruani: Ç'është elasticiteti dhe pse kërkesa për të mira e shërbime është ose jo elastike?

Faqja 2, detyra: Argumentoni: Përse kur kërkesa është elastike, përqindja e ndryshimit në sasinë e kërkuar është më e madhe sesa përqindja e ndryshimit të çmimit të mallit?

Faqja 3, detyra: Argumentoni: Përse kur kërkesa është joelastike, përqindja e ndryshimit në sasinë e kërkuar është më e vogël sesa përqindja e ndryshimit të çmimit të mallit?

Faqja 4, detyra: Argumentoni: Përse kur kërkesa është me elasticitet njësi, përqindja e ndryshimit në sasinë e kërkuar është e barabartë me përqindjen e ndryshimit në çmimin e mallit.

$E > 1$ kërkesë elastike, $E < 1$ kërkesë joelastike, $E = 1$ kërkesë me elasticitet njësi etj.

REFLEKTIMI (Kubimi)

Faqja 5, detyra: Evidentoni: Të mira me kërkesë elastike, joelastike, plotësisht elastike, plotësisht joelastike, duke iu referuar shembujve nga realiteti ekonomik.

Faqja 6, detyra: Interpretoni: Përse në rastet e kërkesës plotësisht elastike dhe plotësisht joelastike lakoret janë pingul me boshtin e abshisave ose paralel me të?

Përfaqësues të grupeve prezantojnë përgjigjet e grupit.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me përkufizimin e elasticitetit të kërkesës;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për evidentimin e shembujve nga realiteti ekonomik;
- për interpretimin e lakoreve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Evidentoni nga hulumtimi i realitetit ekonomik të mira zëvendësuese dhe plotësuese të njëra-tjetrës, për të cilat mund të llogarisim elasticitetin e kryqëzuar të kërkesës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Oferta dhe lakorja e ofertës		Situata e të nxënit: Tregu i CD ndryshimi në vite	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar. Kompetenca e të nxënit: demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përkufizon sasinë e ofruar, ofertën; - shpjegon faktorët kryesorë që ndikojnë tek oferta; - interpreton lakoren e ofertës; - ilustron ligjin e ofertës.		Fjalët kyçe: Sasi e ofruar Oferta Lakore e ofertës Ligji i ofertës	
Burimet: Libri i nxënësit, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Përvijimi i të menduarit - Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI(Brainstorming) Në këtë fazë, nëpërmjet Brainstorming-ut merren ide në lidhje me pyetjen: 1. Bazuar në analogjinë me konceptet e trajtuara më parë, sasi e kërkuar, kërkesë, a mund të përkufizoni sasinë e ofruar dhe ofertën si koncepte ekonomike? Nxënësit ndahen në dy grupe dhe njëri grup jep mendime për përkufizimin e sasisë së ofruar, tjetri për ofertën. Pyetja e dytë në këtë fazë për të dyja grupet është: A mund të tregoni se çfarë ndodh me ofertën e tregut për një produkt kur: a) (për njërin grup), çmimi rritet; b) (për grupin tjetër), çmimi ulet?			

Përgjigjet e nxënësve mund të jenë një prurje e mjaft shembujve, të cilët lehtësojnë formulimin e koncepteve *sasi e ofruar* dhe *ofertë* dhe pothuajse vetëformulojnë ligjin e ofertës në modelin tashmë të njohur të ligjit të kërkesës.

REALIZIMI I KUPTIMIT (Përvijimi i të menduarit)

Në këtë etapë, mësuesi/ja evidenton se si të gjitha qëndrimet e përmendura në stuhinë e mendimeve janë të mundshme dhe të përligjura nga ligji i ofertës. Kështu, për të dyja situatat e sipërpërmendura merret nga një shembull lidhur me rastin kur:

1. çmimi i një të mire rritet dhe sasia e ofruar rritet (veshjet);
2. çmimi i një të mire bie dhe sasia e ofruar bie gjithashtu (ushqimet).

Përkufizohet kërkesa dhe bëhet dallimi midis kërkesës dhe sasisë së kërkuar.

REFLEKTIMI (Punë në grupe)

Mësuesi/ja jep tabelën e mëposhtme :

Çmimi P	Sasia Q e ofruar
20	22
60	34
100	40
140	44
180	46

Ndahet klasa në katër grupe duke numëruar nga 1-4. Për secilin nga grupet jepen detyrat përkatëse:

Grupi 1: Përpiquni të tregoni se çfarë ndodh me sasinë e ofruar (Ligji i ofertës) për një të mirë, kur çmimi i kësaj të mire rritet/ulet.

Grupi 2: Ndërtoni lakoren e ofertës, bazuar në të dhënat e tabelës, dhe përpiquni të evidentoni lidhjen e drejtë çmim - sasi e ofruar.

Grupi 3: Bëni dallimin në paraqitjen grafike dhe në koncept midis sasisë së ofruar dhe ofertës (sasia e ofruar një pikë në lakore; oferta – lakorja).

Grupi 4: Evidentoni se ndryshimi në çmim tregon lëvizje përgjatë lakores, ndikimi i një prej faktorëve si taksat, çmimet e faktorëve të prodhimit, teknologjia etj., bëjnë që lakorja e ofertës të zhvendoset nga e majta ose e djathta, të rritet ose të ulet oferta.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike;
 - për rezultatet e punëve në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Sillni argumente se si vendosja e një takse ul ofertën për një produkt të caktuar dhe e kundërta, subvencionet nxisin sipërmarrësit të ofrojnë më shumë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Elasticiteti i ofertës		Situata e të nxënit: Elasticitet i bukës dhe i furrave për pjekjen e tyre	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai/ajo zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj., në mjediset dhe për audiencat të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij/saj.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> • përkufizon ç'është elasticiteti i ofertës; • evidenton se si e matim elasticitetin e ofertës në lidhje me çmimin e të mirës; • argumenton me shembuj dhe paraqitje grafike raste të ofertës elastike, joelastike, plotësisht elastike, plotësisht joelastike. 		<ul style="list-style-type: none"> Ofertë elastike Ofertë joelastike Ofertë plotësisht elastike Ofertë plotësisht joelastike Ofertë me elasticitet njësi 	
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, <i>Power point</i> , <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Përvijimi i të menduarit - Kubimi - Kubimi			
Organizimi i orës së mësimi			
EVOKIMI (Përvijimi i të menduarit)			
Nëpërmjet kësaj metode kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen:			
1. Si mund ta përkufizoni me fjalët tuaja termin <i>elasticitet i ofertës</i> ?			
Përkufizimet e shkruara nga secili nxënës pasqyrohen në tabelë.			
Evidentohen përcaktimet më afër përkufizimit të saktë dhe i jepet përkufizimi dhe formula e matjes së elasticitetit të ofertës në varësi të përqindjes së ndryshimit të çmimit.			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Kubimi)

Në këtë fazë përdoret një kub, ku numrit të çdo faqeje i korrespondon dhe një detyrë.

Ndahet klasa në 6 grupe. Nga çdo grup, një përfaqësues hedh kubin, në varësi të numrit të faqes i prezantohet grupit detyra. Kjo ndodh me të gjitha grupet. Konkretisht:

Faqja 1, detyra: Analizoni: Ç'është elasticiteti i ofertës dhe pse oferta për të mira dhe shërbime është ose jo elastike dhe cilët janë faktorët që ndikojnë tek ky elasticitet (sasia e produktit që ruhet në magazinë, kapacitetet e pashfrytëzuara prodhuese, cikli i prodhimit të produktit dhe gjatësia e periudhës kohore të marrë në shqyrtim?

Faqja 2, detyra: Argumentoni: Përse kur oferta është elastike, përqindja e ndryshimit në sasinë e ofruar është më e madhe sesa përqindja e ndryshimit të çmimit mallit?

Faqja 3, detyra: Argumentoni: Përse kur oferta është joelastike, përqindja e ndryshimit në sasinë e ofruar është më e vogël sesa përqindja e ndryshimit të çmimit të mallit?

Faqja 4, detyra: Argumentoni: Përse kur oferta është me elasticitet njësi, përqindja e ndryshimit në sasinë e ofruar është e barabartë me përqindjen e ndryshimit të çmimit të mallit?

REFLEKTIMI (Kubimi)

Faqja 5, detyra: Evidentoni: Të mira me ofertë elastike, joelastike, plotësisht elastike, plotësisht joelastike, duke iu referuar shembujve nga realiteti ekonomik.

Faqja 6, detyra: Interpretoni: Përse në rastet e ofertës plotësisht elastike dhe plotësisht joelastike, lakoret janë pingul me boshtin e abshisave ose paralel me të.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:


- për mendimet e dhëna në lidhje me përkufizimin e elasticitetit të ofertës;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për evidentimin e shembujve nga realiteti ekonomik;
- për interpretimin e lakoreve.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Përgatitni një ese ku të argumentoni se si produkte me një cikël të gjatë prodhimi kushtëzojnë elasticitetin e ofertës (p.sh: gruri, vera etj.).

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Ekuilibri i tregut		Situata e të nxënit: Tregu i mobilieve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive, ai/ajo zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj., në mjediset dhe për audiencat të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij/saj.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; - shpjegon faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; - përcakton çmimin dhe sasinë ekuilibër. 		Fjalët kyçe: Ekuilibër i tregut Çmim ekuilibër Sasi ekuilibër Ekuilibër i tregut	
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, <i>Power point</i> , video-projektor, <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Organizues grafik - Shpjegim - Punë e pavarur me shkrim			
Organizimi i orës së mësimi Evokimi (Organizuesi grafik) Në këtë fazë të parë të mësimi do të trajtojmë se si arrihet në një situatë ekuilibër. Me situatë ekuilibër do të kuptojmë situatën kur $Q_d = Q_s$. Ua sqarojmë nxënësve me anë të një paraqitjeje grafike:			
			

Pasi sqaruam se çfarë do të thotë arritja e një situatë ekuilibri, duhet të sqarojmë dhe një situatë dizekuilibri.

Argumentojmë nëpërmjet një organizuesi grafik:

- Ç'është do të thotë një situatë dizekuilibri - mungesë?
- Kur kemi një situatë tepricë në treg?



REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)


Pasi sqaruam me detaje situatën ekuilibër dhe dizekuilibër, kalojmë në një fazë tjetër të mësimin, ku do të shpjegohet se si reagon kërkesa dhe oferta, si pasojë e një reagimi të faktorëve që shkaktojnë ndryshim në to.

Konkretisht shpjegohet:

- Nëse do të rriten të ardhurat e konsumatorit, çfarë do të ndodhë me ekuilibrin e kërkesë-ofertës?

Nxënësve u rikujtohet se rritja e të ardhurave të konsumatorit ndikon drejtpërdrejt në kërkesë.

- Paraqitja grafike e situatës



Reflektimi (Punë e pavarur me shkrim)

Në këtë fazë, pasi nxënësve iu është paraqitur me shembull një situatë ndryshimi, u kërkohet të përcaktojnë:

- Nëse ka një përmirësim teknologjik në prodhimin e një malli; çfarë ndryshimi presim në çmim dhe sasinë ekuilibër.
- Paraqitjen grafike të situatës në rastin kur reduktohen taksat.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për kontributin në ndërtimin e organizuesit grafik;
- për arsyetimet e dhëna gjatë pyetjeve analitike.
- për arsyetimet e dhëna gjatë punës me shkrim;
- për paraqitjen grafike të situatës së dhënë.

Detyra:

Supozojmë se blerësit kanë arsye të besojnë se çmimi i aparateve të telefonisë celulare do të ulet në të ardhmen. Në kushte të tjera të pandryshuara argumentoni:

- Çfarë do të duhej të ndodhte tani me çmimin e tregut të këtij produkti. Pse? Po kur priten përmirësime teknologjike?
- Përgjigjet ilustrojini në mënyrë grafike.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Kontrolli i çmimeve dhe forcat e tregut		Situata e të nxënit: Çmim i teksteve shkollore dhe transportit urban	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit ; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar. Kompetenca e të nxënit : demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përkufizon çmimet tavan dhe dysheme; - arsyeton përse duhet të ndërhyjë shteti në një ekonomi tregu dhe pasojat e kësaj ndërhyrjeje; - argumenton se cila është prirja e çmimeve në një situatë teprice apo mungese në treg.		Fjalët kyçe: Ndërhyrje qeveritare Çmimet tavan Çmimet dysheme Tepricë kërkesë (mungesë) Tepricë oferte	
Burimet: Grafikë, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip –Charter</i> , USB		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Përvijimi i të menduarit - Kllaster			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (Brainstorming) Mësuesi/ja kërkon të marrë informacion në lidhje me çështjen: Në kushtet e ekonomisë së tregut, ku çmimet formohen lirisht në treg nga ballafaqimi i kërkesës dhe ofertës: a) A duhet të ndërhyjë shteti duke vendosur çmime që janë të ndryshme nga çmimi i ekuilibrit? Si duhet të veprojë për një situatë, në të cilën kërkesa për të mira dhe shërbime në treg është më e madhe sesa oferta (kërkesa për shërbimin urban në Tiranë). b) Po në një situatë, në të cilën oferta është më e madhe sesa kërkesa në treg, cila do të ishte ndërhyrja e duhur e shtetit? REALIZIMI I KUPTIMIT (Përvijimi i të menduarit) Klasa ndahet në grupe me nga katër vetë, ku secila nga dyshet e grupeve sjell argumente dhe kundërgjegje lidhur me:			

1. Ndërhyrjen e shtetit në ekonomi me anë të çmimeve tavan dhe dysheme.
2. Pasojat që sjell në shtrembërimin e tregut kjo ndërhyrje.
3. Domosdoshmërinë e përdorimit të këtyre instrumenteve nga ana e shtetit në përpjekje për të mbrojtur grupe të caktuara sociale (rasti i pagës minimale si çmim dysheme dhe i qerasë së banesave si çmim tavan).

REFLEKTIMI (Kllaster)



Në fazën përmbyllëse të orës së mësimit, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që idetë e tyre pro apo kundër ndërhyrjes së shtetit në ekonomi nëpërmjet çmimeve tavan apo dysheme shoqëruar me pasojat për grupe të caktuara sociale t'i paraqesin në një kllaster.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Renditni pasojat negative të vendosjes së çmimeve tavan dhe dysheme, duke sjellë shembuj të tregut të zi; radhëve të gjata apo dhënies së ryshfetit në raste kur aplikohen këto çmime.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Bashkëveprimi midis tregjeve		Situata e të nxënit: Printer i ri? Tregjet ndërvepruese	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - interpreton dhe përkufizon termin e kërkesës së lidhur - interpreton dhe përkufizon termin e kërkesës së prejardhur - analizon efektin e bashkëveprimit të tregjeve		Fjalët kyçe: Bashkëveprimi midis tregjeve Kërkesë e lidhur Kërkesë e prejardhur	
Burimet: Libri, internet, <i>Flip -charter</i> , tabelë magnetike, video- projektor, DVD		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Organizues grafik - Diskutim			
Organizimi i orës së mësimi Evokimi(Brainstorming) Në këtë pjesë të parë të mësimi mësuesja kërkon nga nxënësit që tu përgjigjen disa pyetjeve të cilat do të ndihmojnë në shpjegimin e temës sonë. 1- Nëse ju viheni përpara zgjidhjes ndërmjet 2 produkteve të njëjta celulare, por që njëri është më i lirë kë do të preferonit ju? 2- Nëse do të blini një celular, ju e dini që nga një pakujdesi mund të thyhet a duhet ti blini dhe një kasë telefonit? 3- Çfarë kuptoni me termin kërkesë e prejardhur, po me termin kërkesë e lidhur Realizimi i kuptimit(Organizues grafik) Pasi mësuesja merr përgjigjet për pyetjet e ngritura, fillon me shpjegimin më të detajuar të temës mësimore.			

Ajo nis shpjegimin dhe së pari ju thekson rëndësinë nxënësve të ndërveprimit të tregjeve midis tyre, që do të thotë se kërkesa për një produkt X mund të ndikohet nga çmimi i një produkti tjetër.


Dy rastet të ndërveprimit janë mallra në zëvendësim të konsumit, mallra bashkëplotësuese në konsum.

1- Mallra zëvendësuese në konsum


Nëse do të rritesh çmimi i mollëve, çfarë do të ndodhte me kërkesën për portokaj?

Nëse rritet çmimi i mollëve, konsumatorët do të reduktojnë kërkesën për mollë.

Me reduktimin e kërkesës për mollë, konsumatorët do të preferojnë portokaj kundrejt mollëve dhe do të rrisin kërkesën për portokaj.



Tregu i portokajve




Mallra bashkëplotësues në konsum


Nëse rritet çmimi i makinave, çfarë do të ndodhë me kërkesën për karburant?

Nëse rritet çmimi për makina, atëherë konsumatorët do të ulin kërkesën për karburant, pasi rritja e çmimit të makinave do të shoqërohet me reduktim të sasisë së kërkuar për çdo çmim të makinave e për pasojë në reduktim kërkesë.

Tregu i karburantit



Tregu i makinave



Pasi shpjegon 2 rastet e mësipërme, mësuesi/ja jep dhe njëherë konceptet e kërkesës së prejardhur dhe të lidhur.

REFLEKTIMI(Diskutim)

Në këtë fazë të fundit të mësimit mësuesja hedh për diskutim pyetjen:

A është kërkesa për punonjës të specializuar në shkollat profesionale, kërkesë e prejardhur? Përse?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjen e bërë.
- për përmbushjen e kërkesave të ushtrimit
- për argumentimin e përgjigjeve të dhëna

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në rastin e Shqipërisë, një peshë të konsiderueshme të ekonomisë ka sektori i punësimit aktivi (fason), Ky është një shembull i bashkëveprimit të tregjeve, si një pikëpamje e hallkave të zinxhirit të vlerës së shtuar, ashtu dhe nga pikëpamja e ndërkombëtarizimit të ekonomisë, lidhjes midis ekonomive të vendeve të ndryshme. Cilët faktorë mendoni se i nxisin këto lidhje? Çfarë problemesh mendoni se mund të ketë kjo industri? Çfarë efektesh pozitive sjell kjo industri në ekonominë shqiptare?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Konsumi dhe kursimi		Situata e të nxënit: Llogaritë e kursimit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit ; diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: demonstroi shkathtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon faktorët nga të cilët varet masa e konsumit të një familje ose individit dhe të përshkruan rëndësinë ekonomike të tyre - specifikon burimet e të ardhurave. - arsyeton sesi mund të rritet pasuria dhe nga varet masa e kursimit - analizon kredinë konsumatore - evidenton përfitimet dhe kostot e kredisë konsumatore 		Fjalët kyçe: Pasuria Kursimi Kredia konsumatore	
Burimet: Libri i nxënësit, internet, video-projektor, <i>Flip---charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Brainstorming- Shpjegim- Punë me shkrim, ese			

Organizimi i orës së mësimit

EVOKIMI (Brainstorming)

Mësuesi/ja merr informacion lidhur me pyetjet:

- Cilat janë produktet që ju konsumoni më shumë?
- A ka produkte që ju do të dëshironit ti konsumonit por nga faktorë të ndryshëm nuk mund ti konsumoni?
- A keni para të lëna mënjanë ju apo familja juaj? Si do të emërtohej me një term ekonomik kjo sjellje?
- Nëse familja juaj ka mungesë të ardhurash dhe duhet të bëjnë një pagesë me patjetër, si do të veprohej në këtë situatë?

Pasi nxënësit paraqesin përgjigjet e tyre, i pasqyrojmë në tabelë

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Pasi merren përgjigjet e nxënësve, mësuesja u shpjegon lidhjen e përgjigjeve të tyre me termat për të cilat do të diskutohet në mësim. Përkatësisht:

- Konsum
- Kursim
- Kredi konsumatore
- Të ardhura

Së fundi mësuesi/ja shpjegon dhe ndryshimin midis të ardhurave dhe pasurisë

REFLEKTIM (Punë me shkrim, ese)

Në minutat e mbetura nxënësve u kërkohet të krijojnë një ese argumentuese me temë “ Pse konsumimi është një katalizator i mirë për ekonominë”

Në përfundim, përfaqësues të ndryshëm lexojnë esetë e krijuara.

Vlerësimi: I vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e bëra
- për krijimin e esesë
- për argumentet e dhëna në ese

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një ese rreth prirjeve si konsumator në një ekonomi globale

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Buxheti Vetjak		Situata e të nxënimit: Buxheti ynë	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai/ajo zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj., në mjedisë dhe për audiencë të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij/saj.</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja - analizon buxhetin vetjak dhe përcakton çfarë duhet të mbahet parasysh në hartimin e tij; - interpreton si pasqyrohen të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet në buxhetin vetjak.		Fjalët kyçe: Buxheti vetjak Të ardhura personale Shpenzime Kursimi	
Burimet: Libri i nxënësit, video-projektor, Flip-charter, internet – web Banka e Shqipërisë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve : Brainstorming – Shpjegim - Studim rasti			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Mësuesi/ja i paraqet në tabelë një pyetje të rëndësishme:			
<ul style="list-style-type: none"> - Përse është e rëndësishme të parashikojmë të ardhurat dhe shpenzimet vetjake përgjatë një periudhe kohore? Dhe kërkon mendimet e nxënësve, të cilat i pasqyrojnë në tabelën e zezë. 			
REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)			
Mësuesi/ja nëpërmjet shpjegimit sqaron se si mund të ndërtojme një buxhet vetjak duke paraqitur në tabelë një strukturë të organizimit të buxhetit vetjak; duke pasqyruar kategoritë kryesore dhe në mënyrë të përmbledhur.			

Të ardhurat	Shpenzimet	Kursimi
Të ardhura nga paga	Shpenzime të domosdoshme	
Të ardhura të tjera	Shpenzime jo të domosdoshme	
Total (1)	Total (2)	(1-2)

REFLEKTIMI (Studim rasti)

Në këtë fazë, mësuesi/ja jep një rast studimor:

Supozojmë se një individ i sapodiplomuar është punësuar para 1 viti me një pagë prej 50 000 lekësh në muaj.

Shpenzimet e tij janë të domosdoshme, ku përfshihen qiraja prej 15 000 lekësh, energjia elektrike prej 2 200 lekësh, gjithashtu edhe shpenzime jo të domosdoshme për argëtim e dhurata, në masën 1800.

Kërkohet:

- a) Të paraqitet një buxhet vetjak në bazë të kategorive kryesore.
- b) Të përcaktohen zërat në kategoritë e duhura.
- c) Të tregohet nëse rezulton kursimtar apo jo i sapodiplomuari dhe të argumentohet përgjigjja.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjen e bërë;
- për përmbushjen e kërkesave të ushtrimit;
- për argumentimin e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Bëni parashikimin për buxhetin tuaj ose të familjes për muajin e ardhshëm, duke marrë në konsideratë shpenzimet dhe të ardhurat e saj.

PROJEKT (ORA E PARË)

Tema: Pamjaftueshmëria, zgjedhja dhe kostoja oportune, sfidë e çdo individi, familjeje dhe shoqërie

Rezultatet e të nxënësve

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- shpjegon lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune;
- shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe materiale të tjera mbështetëse për realizimin e projektit;
- identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;
- përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafikë, diagrame me të dhëna statistikore);
- evidenton shembuj lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune;
- analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj.

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, kllastera dhe materiale të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

Libri i nxënësit, materiale të printuara (materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara), materiale të siguruar nga interneti, internet, CD / DVD / USB, kompjuter, video-projektore, tabelë prezantimi, shënjeshtër etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

- Identifikimi i burimeve prodhuese
- Kufizueshmëria e burimeve përballë nevojave të pakufizuara
- Përshkrimi i kufirit të mundësive të prodhimit të një shoqërie
- Konkretizimi me shembuj i një situatë në lidhje me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj
- Ndërtimi dhe interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune
- Interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune
- Përshkrimi i parimit të ekonomizimit
- Analizimi se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor
- Argumentimi për mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

- Nxënësit ndahen në grupe, me nga katër anëtarë secili.
- Përcaktohen: përmbajtja e projektit, burimet e informacionit, mënyrat se si do të punojnë dhe komunikojnë nxënësit.
- Mësuesi/ja jep sugjerime mbi organizimin e punës brenda grupit.
- Nxënësit ndajnë rolet brenda grupit dhe detyrat për secilin.

PROJEKT (ORA E DYTË)

Tema: Pamjaftueshmëria, zgjedhja dhe kostoja oportune, sfidë e çdo individi, familjeje dhe shoqërie

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- shpjegon lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune;
- shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe materiale të tjera mbështetëse për realizimin e projektit;
- identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;
- përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafikë, diagrame me të dhëna statistikore);
- evidenton shembuj lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;
- analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj.

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, kllastera dhe materiale të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

Libri i nxënësit, materiale të printuara (materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara), materiale të siguruar nga interneti, internet , CD / DVD / USB, kompjuter, video-projektor, tabelë prezantimi, shënjes etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:

- Identifikimi i burimeve prodhuese
- Kufizueshmëria e burimeve përballë nevojave të pakufizuara
- Përshkrimi i kufirit të mundësive të prodhimit të një shoqërie
- Konkretizimi me shembuj i një situatë në lidhje me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj
- Ndërtimi dhe interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune
- Interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune.
- Përshkrimi i parimit të ekonomizimit
- Analizimi se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor
- Argumentimi për mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

- Nxënësit përshkruajnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit. Tashmë, ai duhet të jetë në trajtën e një raporti paraprak, ndaj këshillohen nga mësuesi/ ja t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë projektit në lidhje me origjinalitetin dhe cilësinë, për të pasur një produkt sa më të frytshëm në fazën përfundimtare.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre.
- Nxënësit përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmërinë e tyre.
- Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.

PROJEKT (ORA E TRETË)

Tema: Pamjaftueshmëria, zgjedhja dhe kostoja oportune, sfidë e çdo individi, familjeje dhe shoqërie

Rezultatet e të nxënësve

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- shpjegon lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune;
- shfrytëzon teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe materiale të tjera mbështetëse për realizimin e projektit;
- identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;
- përzgjedh informacionin dhe e përpunon atë (ndërton grafikë, diagrame me të dhëna statistikore);
- evidenton shembuj lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;
- analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;
- vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve (idetë individuale dhe ato në grup);
- tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- është krijues, prezanton idetë e reja dhe komunikon lirshëm mendimet e tij/saj;

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, kllastera dhe materiale të hulumtuara e të grumbulluara gjatë zhvillimit të temave mësimore; biseda me më të rriturit e familjes; informacione të siguruar nga interneti, media dhe dokumentarë të ndryshëm televizivë.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

Libri i nxënësit, materiale të printuara (materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara), materiale të siguruar nga interneti, internet, CD / DVD / USB, kompjuter, video-projektor, *smartboard*, shënjes etj.

Çështjet që do të trajtohen gjatë realizimit të projektit:



- Identifikimi i burimeve prodhuese
- Kufizueshmëria e burimeve përballë nevojave të pakufizuara
- Përshkrimi i kufirit të mundësive të prodhimit të një shoqërie
- Konkretizimi me shembuj i një situatë në lidhje me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj
- Ndërtimi dhe interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune
- Interpretimi i një lakoreje të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj, ilustrimi i koston oportune
- Përshkrimi i parimit të ekonomizimit
- Analizimi se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor
- Argumentimi për mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor

Përshkrim përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së tretë të projektit

- Paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet në mënyrë elektronike (me *Power Point* apo me forma të tjera) ose me anë të posterave, skemave etj., sipas vendimmarrjes së grupit.
- Dorëzimi i produktit të printuar.
- Diskutimi në klasë mbi përfundimet e arritura.
- Vlerësimi i nxënësve.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Firmat, sipërmarrësit dhe ekonomia e tregut		Situata e të nxënët: Amazon “dyqani në internet”	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: demonstroi shkathhtësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura.			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përkufizon ç’është firma - shpjegon cilat janë qëllimet e veprimtarisë së firmës në ekonominë e tregut		Fjalët kyçe: Sipërmarrës Firmë	
Burimet: Libri i nxënësit, tabela e zezë, video-projektor, <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kllaster-Shpjegim- Rrjet diskutimesh			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (Kllaster) Duke ju rikthyer kapitujve të shpjeguar më parë, rikthejmë në vëmendjen e nxënësve se ekonomia është një shkencë e cila studion përndarjen optimale të burimeve të kufizuara prodhuese ndaj nevojave konkurruese. Ajo studion dhe analizon veprimtarinë e agjentëve se saj, ndër të cilët mund të përmendim firmën. Në këtë moment zhvillohet kllasteri në lidhje me çështjet e mëposhtme: -Çfarë kuptoni me firmë? -Nga kush drejtohet firma?			
			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Nëpërmjet shpjegimit sqarohen çështjet e mëposhtme:

- 1) Cili është roli i sipërmarrësit në ekonominë e tregut
- 2) Çfarë rruge mund të ndjekin sipërmarrësit për të patur sukses:

REFLEKTIMI (Rrjet diskutimesh)

Në këtë pjesë të fundit të mësimit hedhim për diskutim pyetjen:

PO		JO
┌	A mund të bëhet çdo njëri sipërmarrës? Pse?	┌
└		└

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:


Listoni disa nga strategjitë që duhet të përdor një sipërmarrës që të jetë i suksesshëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Format e organizimit të një biznesi		Situata e të nxënimit: Ushtrime dhe situata problemore nga jeta reale	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: demonstroi shkathësi funksionale të ekonomisë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre; parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre, bën përmbledhjen e politikave të përdorura			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - evidenton legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e biznesit në Shqipëri - evidenton format kryesore të shoqërive në vendin tonë - analizon format kryesore të shoqërive në vendin tonë - konkretizon me shembuj format e organizimit dhe të funksionimit të biznesit në vendin tonë.		Fjalët kyçe: Shoqëri kolektive Shoqëri komandite Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Shoqëri anonime Shoqëri shtetërore	
Burimet: Libri, video projektor, <i>Flip--charter</i> , internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim me terma paraprakë -Shpjegim -Diskutim			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI (Parashikim me terma paraprakë) Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: Ligje biznese shoqëri kolektive shoqëri komandite shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shoqëri anonime shoqëri shtetërore Dhe kërkon nga nxënësit të përshkruajnë kuptimin e tyre. Më pas idetë shkruhen në tabelë dhe lexohen nga një nxënësi REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim) Në këtë fazë mësuesi/ja nëpërmjet shpjegimit sqaron:			

- Thelbi e tri ligjeve që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e bizneseve në vendin tonë
- Format kryesore të shoqërive në vendin tonë
- Karakteristikat e shoqërive



REFLEKTIMI (Diskutim)

Në këtë fazë shtrohen për diskutim pyetjet:

Cila prej formave të biznesit haset më shpesh dhe pse?

Cila prej formave të biznesit haset më rrallë dhe pse?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

-për mendimet e dhëna në lidhje me përshkrimet e bëra

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për idetë e dhëna

Detyrat dhe puna e pavarur:

Jepni shembuj të formave të organizimit dhe funksionit të biznesit në vendin tonë dhe në zonën ku banoni.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Financimi i firmës		Situata e të nxënit: “Elektronik Design”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Financim i brendshëm	
- specifikon cilat janë rrugët e financimit të një biznesi		Financim i jashtëm	
- dallon burimet e jashtme nga burimet e brendshme		Aksion	
- dallon ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit		Obligacion	
		Marrje kredie	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, internet, <i>Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve (Brainstorming)-Leksion i avancuar-Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Mësuesi/ja merr ide për pyetjet e mëposhtme:			
1. Cilat mund të jenë rrugët kryesore që firmat përdorin për të siguruar mjetet financiare?			
2. Cilën nga rrugët e sigurimit të mjeteve monetare do të vlerësonit si më të mirë dhe më të sigurt?			
3. Ç'dini për aksionin dhe obligacionin? Çfarë kanë të përbashkët dhe çfarë i dallon nga njëri-tjetri?			
4. Ç'është kredia bankare? A janë të sigurtat firmat në marrjen e kredisë nga banka?			
Pasi dëgjohen përgjigjet e nxënësve, disa prej tyre shkruhen në tabelë dhe mësuesi përzgjedh ato që kanë lidhje me temën e re.			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Leksion i avancuar)			
Në fillim mësuesi/ja përgatit nxënësit për veprimtarinë duke u treguar temën e leksionit dhe objektivat e tij. Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe .Brenda grupeve krijohen dyshe			

nxënësish të cilët duhet të hartojnë një listë mbi gjithçka që dinë rreth kësaj teme. Mësuesi/ja u kërkon dysheve t'ia tregojnë punën e tyre shokëve. Më pas shkruhen në tabelë idetë .U kërkohet nxënësve të dëgjojnë me vëmendje mësimin, të dhënë nga mësuesi/ja duke pasur para listën e tyre të ideve. Bëhet krahasimi i ideve me mësimin e dhënë.

REFLEKTIMI (Brainstorming)

Në 5 - 10 minutat e fundit të orës bëhen pyetje të cilave nxënësit iu përgjigjen me shkrim:

1. Cilat prej letrave sjellin interesa fikse dhe cilat dividendë?
2. Cilat janë motivet që na shtyjnë të mbajmë aksione?
3. Cilat janë motivet që na shtyjnë të mbajmë obligacione?

Disa nga nxënësit lexojnë përgjigjet e dhëna dhe diskutohen me të gjithë klasën.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:



- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u kërkohet të bëjnë një kërkim në faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë lidhur me ecurinë e nivelit të kredidhënies për bizneset shqiptare.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Bilanci i firmës		Situata e të nxënit: Bilanci i firmës "Livadh" sh.p.k"	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme. Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - evidenton dy dokumentet bazë të kontabilitetit - interpreton pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve - interpreton pasqyrën e bilancit të firmës - shpjegon barazimin kryesor kontabël mbi bazën e të cilit ndërtohet bilanci		Fjalët kyçe: Bilanci i firmës Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve Fitim kontabël Aktivi, pasivi	
Burimet: Libri, video-projektor, <i>Flip-charter</i> , internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Parashikim me terma paraprakë - Shpjegim- Studim rasti			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI (parashikim me terma paraprakë) Mësuesi/ja shkruan në tabelë dy konceptet:			
			
Pyeten nxënësit nëse kanë ndonjë informacion në lidhje me konceptet ose se çfarë mendojnë në lidhje me to.			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Në fazën e dytë mësuesi/ja shpjegon se:

- Bilanci i firmës dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve janë dy dokumentet bazë të një firme apo biznesi
- Të ardhurat totale - Kostot totale kontabël - = Fitim(ose humbje) kontabël
- Barazimi themelor kontabël mbi bazën e të cilit ndërtohet bilanci është: Mjetet =Detyrimet + Vlerën neto të firmës

REFLEKTIMI (Studim rasti)

Arbëri dhe Vjollca vendosën të fillojnë një biznes. Në fund të vitit të parë dëshironin të dinin rezultatin e aktivitetit të tyre. Të dhënat që disponojnë janë:

të ardhura nga shitja 1800 dollarë;

të ardhura nga qiratë 200 dollarë;

të ardhurat nga shërbimet që u ofrojnë të tretëve 100 dollarë.

pagesat për pagat 600 dollarë;

pagesat për furnizimin me lëndë të parë 800 dollarë;

pagesa e interesit bankar 200 dollarë;

amortizimi i kapitalit 100 dollarë.

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme tregoni nëse biznesi i tyre është me humbje apo me fitim.

Në fillim nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe pastaj një nxënës e punon në tabelë. Pjesa tjetër e nxënësve diskutojnë mbi pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe rezultatin e nxjerrë.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

-për mendimet e dhëna

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për punën e bërë në grupe

Detyrat dhe puna e pavarur:

Arsyetoni: Pse një menaxher apo një individ që dëshiron të investojë paratë e tij në një firmë duhet të njohë dy dokumentet kryesore kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe bilancin e firmës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Prodhimi		Situata e të nxënit: Prodhim i produkteve artizanale “toka jonë”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatohet strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni;. demonstroi shkathësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton ç’është prodhimi -identifikon kategoritë kryesore të prodhimit - dallon funksionin e prodhimit - interpreton funksionin e prodhimit në periudha afatshkurtra dhe afatgjata - shpjegon treguesit kryesorë të prodhimit - interpreton në grafik ligjin e të ardhurave rënëse 		Prodhimi Funksioni i prodhimit periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë, produkt i përgjithshëm fizik produkt marxhinal fizik produkt mesatar fizik ligji i të ardhurave rënëse	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, dërrasë e zezë, <i>Power point, Flip--charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Leksion i avancuar- Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen:			
<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë kuptoni me fjalën prodhim? -Cilat mund të jenë kategoritë kryesore të prodhimit? 			
Mendimet e nxënësve vendosen në tabelë.			
Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në idetë e nxënësve, nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj.			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Leksion i avancuar)			
Në fazën e dytë mësuesi/ja nis me shpjegimin e koncepteve:			
-kuptimi i funksionit të prodhimit			

- funksioni i prodhimit në periudha afatshkurtër dhe afatgjatë
- produkti i përgjithshëm fizik
- produkti marxhinal fizik
- produkti mesatar fizik
- faktorët e ndryshueshëm dhe të pandryshueshëm të prodhimit
- interpretimi grafik i prodhimit në periudhën ASH

➤ 1. Trajtohet funksioni i prodhimit në konceptimin

○ Ekonomik si një proces në të cilin faktorët e prodhimit (burimet) sipas një metode të caktuar kthehen në mallra.

○ Matematikor, si funksioni që paraqet çdo kombinim të faktorëve të prodhimit në një periudhë të caktuar kohe dhe që tregon maksimumin e prodhimit në saj të këtij kombinimi .

$$Q_{\max} = f(K, L)$$

Këtu mësuesi ndalet dhe ve theksin në faktin që:

Shprehja algjebrike që nxënësit e kanë përmendur më parë si të njohur nga matematika tregon këtu se madhësia e prodhimit maksimal të firmës Q është funksion i madhësisë së faktorëve të ndryshëm të përdorur në procesin e prodhimit .

➤ Evidentohet se si ndryshimi në periudhën afatshkurtër me periudhën afatgjatë përbën një moment kyç në trajtimin e funksionit të prodhimit, duke pasur parasysh se në periudhë afatshkurtër të paktën njëri nga faktorët mbetet fiks dhe në periudhë afatgjatë të gjithë faktorët mund të ndryshohen (shumëfishohen).

➤ Theksohet rëndësia e paraqitjes grafike të funksionit të prodhimit dhe trajta e lakores së TPP, APP, MPP.

REFLEKTIMI(Punë në grupe)

Jepet nga mësuesi/ja tabela:

L	TPP	MPP	APP
0	0		
1	70		
2	160		
3	244		
4	312		
5	354		
6	360		

Ndahet klasa në tre grupe dhe për secilin grup një detyrë. Konkretisht:

Grupi 1: Duhet të bëjë paraqitjen grafike të lakores së produktit të përgjithshëm fizik

Grupi 2:Duhet të plotësojë tabelën për treguesin MPP dhe të bëjë paraqitjen grafike të lakores së produktit marxhinal fizik.

Grupi 3.:Duhet të plotësojë tabelën për treguesin APP dhe të bëjë paraqitjen grafike të lakores së produktit mesatar fizik.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për punën e bërë në grupe

Detyrat dhe puna e pavarur:

Tabela e mëposhtme tregon sasinë e produktit që prodhohet dhe njësinë e punës të një firme.Duke ditur që madhësia e kapitalit është e fiksuar tregoni:

Puna	0	1	2	3	4	5	6
Produkti	0	2	5	10	14	17	19

- A) Për cilën periudhë prodhimi bëhet fjalë _____
- B) Sa është produkti mesatar fizik kur firma ka punësuar 3 punëtorë?

- C) Sa është produkti marxhinal kur firma ka punësuar 5 punëtorë?

- D) A ka vend në këtë rast ligji i të ardhurave në rënie.

- E) Argumento përgjigjen e dhënë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Të ardhurat dhe kostot		Situata e të nxënit: “Ajkuna Sh.p.k”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera . Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni;. demonstroi shkathësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shpjegon kuptimin e të ardhurave - shpjegon kuptimin e kostos marxhinale - dallon llojet e kostove - bën dallimin midis kostos kontabile dhe kostos oportune; midis fitimit kontabël dhe fitimit ekonomik		Fjalët kyçe: të ardhura marxhinale, kosto fikse, kosto e ndryshueshme, kosto e përgjithshme, kosto marxhinale,	
Burimet: Libri, dërrasë e zezë, <i>Power point, Flip--charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming-Shpjegim- Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimi EVOKIMI(Brainstorming) Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen: - Çfarë kuptoni me fjalën e ardhur? - Çfarë kuptoni me fjalën kosto? Mendimet e dhëna nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë. Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në mendimet e dhëna nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj.			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim) Në fazën e dytë mësuesi/ja nëpërmjet shpjegimit sqaron: -Kuptimin e të ardhurave, ku $TR = P \cdot Q$ dhe llojet e të ardhurave -Kuptimin e të ardhurave mesatare, ku $AR = TR / Q$ -Kuptimin e të ardhurave marxhinale, ku $MR = \Delta TR / \Delta Q$ -Llojet e kostove, kuptimi dhe llogaritja e tyre			

-Koston e përgjithshme mesatare, $ATC = TC/Q$; koston fikse mesatare, $AFC = FC/Q$; koston e ndryshueshme mesatare, $AVC = VC/Q$

-Kostoja marxhinale, kuptimi dhe llogaritja e saj, ku $MC = \Delta TC / \Delta Q$

-Koston kontabile si tërësi shpenzimesh monetare që bën firma për prodhimin e mallit

-Koston oportune si tërësia e faktorëve të prodhimit që janë pronë e firmës por që kanë alternativa të tjera përdorimi.

-Fitimin kontabël = $TR - TC_{kontabile}$

-Fitimin ekonomik = $TR - TC_{oportune}$

REFLEKTIMI (Brainstorming)

Nxënësit i përgjigjen pyetjes së mëposhtme:

-Në qoftë se për një firmë: TR janë 100000 \$, $TC_{kontabile}$ është 60000\$: $TC_{oportune}$ është 90000 \$, sa do të jetë fitimi kontabile dhe sa fitimi ekonomik?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me përkufizimin e të ardhurave dhe koston
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për saktësinë në llogaritje të të ardhurave dhe kostove

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në tabelën vijuese jepen të dhënat e firmës.

Çmimi (P)	Sasia e kërkuar (Qd)	Të ardhura totale (TR)	Të ardhurat marxhinale (MR)	Kosto totale (TC)	Kosto marxhinale (MC)	Fitim ose humbje
20	0			4		
16	1			10		
12	2			14		
10	3			20		
7	4			28		
4	5			40		

Llogarisni:

- A) Të ardhurat totale të firmës për çdo njësi të kërkuar.
- B) Të ardhurat marxhinale të firmës.
- C) Koston marxhinale të firmës.
- D) Sa do të jenë fitimet ose humbjet e firmës.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Lakoret e kostos në periudhën afatshkurtër		Situata e të nxënët:	
<p>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe:</p> <p>Kompetenca e të shprehurit: përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton lakoret e kostove në periudha afatshkurtra - interpreton në mënyrë grafike: lakoret e kostove fikse (AFC), të kostove variable mesatare (AVC), të kostos së përgjithshme mesatare (ATC), të kostos marxhinale (MC) 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të ardhura marxhinale Lakoret e kostos Kosto marxhinale 	
<p>Burimet:</p> <p>Libri, dërrasë e zezë, <i>Power point</i>, <i>Flip--charter</i></p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Organizues grafik (Kubimi)</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>EVOKIMI(Brainstorming)</p> <p>Mësuesi/ja nis me një Brainstorming në lidhje me pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë është kostoja dhe pse ka rëndësi llogaritja e saj? - Cili është kuptimi i kostove mesatare dhe marxhinale dhe si llogariten ato? <p>Përgjigjet shkruhen në tabelë.</p> <p>REALIZIMI I KUPTIMIT(Organizues grafik)</p> <p>Si rrjedhojë e koncepteve të marra në leksionin e mëparshëm, me interes qëndron sesi janë sjelljet e kostove si pasojë e ndryshimeve të njësisive të prodhimit. A reflektohet ndryshimi në njësitë e prodhuara në një sjellje të caktuar të kurbës (lakores) së kostos: variable, fikse, marxhinale dhe asaj mesatare</p>			

Për ti dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura, ndihmojnë organizuesit grafik nëpërmjet të cilëve analizohet dhe interpretohet grafikisht kategoritë e kostove në afatshkurtër:


Së pari nisim me $AFC = FC/Q$ e cila paraqitet grafikisht do ta kishte si më poshtë



AFC Analiza

Duke marrë në konsideratë këtë sjellje e duke u nisur nga formula, themi AFC se me rritjen e prodhimit kostoja fikse mesatare reduktohet, drejt zeros pasi TFC Q kostoja fikse shpërndahet në të gjitha njësitë e prodhuara, duke marrë në konsideratë se TFC është e pandryshueshme për çdo njësi


Pasi analizohet kosto fikse, shpjegimi tashmë përqendrohet tek kostoja variable. E cila gjendet = VC/Q



AVC Analiza

Paraqitja grafike e koston mesatare tregon se çfarë ndodh me koston Variable me ndryshimin e prodhimit, duke parë grafikun vërehet se AVC me rritjen e prodhimit kostoja variable për njësi mesatare rritet


Kalohet më pas tek një kategori tjetër, kosto mesatare $ATC = TC/Q$ e cila grafikisht paraqitet



ATC Analiza

Kostoja mesatare fillimisht ka prirje rënëse, e më pas rritëse

Kostoja marzhinale = $\Delta TC/\Delta Q$ e cila paraqet koston shtesë për njësi, si pasojë e rritjes së prodhimit.




MC Analiza

Kjo kurbë kostoje ka prirje rënëse në fillim dhe pas një niveli rritës

Ardhur nga fakti se pasi arrihet niveli që minimizon koston, pra niveli MC ku burimet përdoren me efikasitet, pas këtij niveli burimet përdoren me kosto më të larta

REFLEKTIMI (Diskutime)

Në këtë fazë shtrohet për diskutim pyetja:

 <p>PO</p> <p>A mendoni ju se fermat e vogla kanë më shumë mundësi për ekonomizime shkalle?</p> <p>JO</p>
<p>Vlerësimi: i vazhdueshëm</p> <p>Nxënësit vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none">-për mendimet e dhëna në lidhje me përkufizimin e të ardhurave dhe kostos marxhinale-për arsyetimet gjatë diskutimit në lidhje me lakoret e kostove në periudha afatshkurtra-për saktësinë në llogaritje të të ardhurave dhe kostove
<p>Detyrat dhe puna e pavarur:</p> <p>Nxënësve u kërkohet që të reflektojnë dhe të analizojnë a ekziston ndonjë lidhje midis lakoreve dhe nëse po ndërmjet kujt?</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Prodhueshmëria		Situata e të nxënit: Vlerësim i nxënësit nga nxënësi-mësuesi	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<p>Kompetenca e të shprehurit: përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon konceptin e prodhueshmërinë - liston dhe shpjegon faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri - vlerëson prodhueshmërinë 		<ul style="list-style-type: none"> standard jetese, prodhueshmëri kapital njerëzor/fizik, teknologji 	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, <i>smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip--charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim - Diskutim			

Organizimi i orës së mësimit

EVOKIMI (Brainstorming)

Mësuesi/ja merr informacion lidhur me pyetjet:

- Çfarë ishte prodhimi?
- Kur një punonjës është shumë eficient dhe me të njëjta kushte si të tjerët prodhon më shumë, ku ndikon kjo gjë?
- Çfarë kuptoni me prodhueshmëri

Përgjigjet e pyetjeve, mësuesi/ja i shkruan në tabelë.

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Mësuesi/ja shpjegon termin e prodhueshmërisë tregon sasinë dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara me një sasi dhe cilësi të dhënë të faktorëve të prodhimit në një hark kohor.

- **Si llogaritet treguesi i prodhueshmërisë:**

$$\text{Prodhueshmëria} = \frac{\text{Produkt kombëtar real}}{\text{Sasia e faktorit të përdorur}}$$


Cilët janë faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri:

- Sasia dhe cilësia e kapitalit njerëzor
- Rritja e sasisë dhe cilësisë së kapitalit fizik.
- Përmirësimi i teknologjisë
- Kushtet në të cilat zhvillohet biznesi

Mësuesi/ja shpjegon shkurtimisht dhe efektet e secilit prej faktorëve dhe kërkon dhe mendimin e nxënësve se si mund të ndikojë një përmirësim i secilit prej tyre në prodhueshmëri

REFLEKTIMI (Diskutim)

Në këtë fazë shtrohet për diskutim pyetja:



Vlerësimi:


: i vazhdueshëm. Nxënësit vlerësohen: -për përmbledhjen e materialit të lexuar. -për arsyetimet gjatë diskutimit-për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:


A kanë ndikuar përparimet teknologjike në botë edhe në prodhueshmërinë e faktorit kapital në Shqipëri? Jepni shembuj konkretë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomi 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Thelbi i konkurrencës		Situata e të nxënit:	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <p>Kompetenca e të shprehurit: përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan konceptin e konkurrencës - interpreton struktura të ndryshme tregu - argumenton pse nga konkurrenca fitojnë të gjithë agjentët ekonomik 		<p>Fjalët kyçe:</p> <p>konkurrenca struktura e tregut konkurrenca e plotë konkurrenca monopolistike oligopoli monopoli (telefonja e lëvizshme, karburantet)</p>	
<p>Burimet:</p> <p><i>Smart board</i>, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip- charter</i>, USB, artikuj ose raste studimore në të cilat evidentohen strukturat e tregut, sidomos ato oligopol apo monopol.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Të nxënit në bashkëpunim - Rrjet i diskutimit</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>EVOKIMI (Brainstorming = Harta e të menduarit)</p> <p>Mësuesi/ja merr idetë e gjithë secilit në lidhje me problemet e mëposhtme dhe ndërton një hartë të të menduarit ër 5 nga termat kyç që do të përmenden në këtë temë si:</p> <p>1 A keni dëgjuar për temin Konkurrencë? Cilat janë fjalët që ju vijnë në mend kur dëgjoni këtë term?</p>			
			

2 Çfarë dini për termat *konkurrencë e plotë*, *konkurrencë monopolistike*, *oligopol*, *monopol*? Shkruani në mini-hartat e mëposhtme fjalët që ju vijnë në kujtesë sapo përmenden këto fjalë.



REALIZIMI i KUPTIMIT (Të nxënit në bashkëpunim)

Në këtë etapë të orës së mësimit nxënësve ju shpërndahen reklama të kompanive të tilla si

1. Parukeri & Estetikë “Krehri i Argjendte”
2. Dyqani i veshjeve “NIKE”
3. Kompani e telefonisë celulare *Eagle*
4. Korporata energjetike shqiptare

Nxënësve ju kërkohet që të vendosin secilën prej tyre duke u bazuar në strukturat e tregut të ndërtuara nga Harta e të menduarit.

Mësuesi evidenton bazuar edhe në hartën e të menduarit karakteristikat e secilës strukturë duke qëndruar më shumë tek rëndësia e studimit të strukturave të tregut.

REFLEKTIMI (Rrjet i diskutimit)

Në këtë fazë shtrohet për diskutim pyetja:

PO

JO

A është i rëndësishëm diferencimi
i produktit në konkurrencën monopolistike?
Pse

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim gjatë orës së mësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve ju kërkohet të bëjnë një evidencë të subjekteve ekonomike sipas strukturës së tregut për zonën në të cilën jetojnë si dhe të evidentojnë në grafik përqindjen që zë secila formë konkurrence.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Struktura e tregut në konkurrencë e plotë		Situata e të nxënit: “Dora e padukshme”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi/ja zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan konkurrencën e plotë dhe veçoritë e saj si strukturë tregu - analizon sjelljen shitësve dhe blerësve në kushtet e konkurrencës së plotë - argumenton trajtën e lakores së kërkesës në konkurrencën e plotë 		konkurrencë e plotë produkt homogjen firmë çmim-pranuese hyrje dhe dalje e lirë nga tregu.	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Legjislacioni lidhur me Konkurrencën në treg <i>smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip--charter</i> , USB, informacione e raste studimore të strukturës konkurrencë e plotë			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Të nxënit në bashkëpunim - Kllaster			

Organizimi i orës së mësimit

EVOKIMI (Brainstorming)

Mësuesi/ja merr idetë e gjithë secilit fokusuar në problemet e mëposhtme:

1. A keni dëgjuar ndonjëherë të flitet për ekzistencën e “një dore të padukshme” në ekonominë e tregut?
2. Me çfarë mendoni se ka të bëjë kjo shprehje dhe si mund ta përligjim atë?
3. A mendoni Ju se pjesa më e madhe në numër e firmave apo subjekteve ekonomike operojnë në strukturë tregu -Konkurrencë e plotë? Pse?
4. Cilat mendoni se janë lehtësitë dhe vështirësitë e të operuarit në një strukturë të tillë tregu?
5. Vendosni + në tabelën e mëposhtme nëse mendoni se tiparet e poshtëshënuara janë karakteristikë e kësaj strukture tregu.

KONKURRENCA E PLOTE karakterizohet nga:

Produkt homogjen	Informacion i plotë	Hyrje & Dalje e lirë në treg	Firmat janë çmim-pranuese	Produkt unik	Marketing i fuqishëm

REALIZIMI i KUPTIMIT (Të nxënësit në bashkëpunim)


Në këtë etapë të orës së mësimit nxënësit janë jo vetëm përfitues të këtij procesi por edhe kontribues, pasi një pjesë e mirë e veçorive të konkurrencë së plotë janë evidentuar në etapën e parë dhe lehtësisht ata mund të përqëndrohen tek

- Lakorja e kërkesës në konkurrencën e plotë dhe trajtën e saj të një kërkesë plotësisht elastike, ç’ka do të thotë se ndikimi i cilësdo firmë në treg është praktikisht zero.
- Fakti që çmimi i shitjes së çdo njësie në treg nuk ndryshon na çon në rezultatin e matshëm:

$$d=AR=MR=P$$

REFLEKTIMI (Kllaster)

Mësuesi/ja në këtë etapë të orës së mësimit orjenton nxënësit që duke ju referuar modelit teorik të konkurrencës së plotë dhe shembujve të evidentojnë edhe njëherë karakteristikat e kësaj strukture për shembuj të papërmendur deri në këtë moment,

**Vlerësimi: i vazhdueshëm**

Nxënësit vlerësohen:

- për përgjigjet e dhëna në lidhje me pyetjet e mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim në mësim

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësvë ju kërkohet të përlogaritën të ardhurat totale, mesatare, marzhinale për një firmë që operon në konkurrencë të plotë dhe ka një rritje të Q (produktit të shitur nga 10, 20, 30, 40, 50 Kv dhe çmimi i shitjes mbetet 15 L/kg si dhe të ilustruhet situata në grafik

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Analiza ekonomike e firmës në konkurrencë të plotë në afat të shkurtër		Situata e të nxënimit: “Dora e padukshme”	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën eligjite, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Fitim normal	
- përcakton Pe dhe Qe të firmës		Fitim ekonomik	
- llogarit π , (fitimi total) AR, AC, TR, TC		Fitimin kontabël	
- interpreton në grafik dhe π dhe ekuilibrin e firmës			
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, dërrasë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming - Shpjegim - Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Nëpërmjet brainstormingut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjet:			
-Çfarë quajmë produkt optimal?			
-Çfarë quajmë fitim ekonomik/kontabël dhe fitim normal?			
-Si duhet të veprojë firma kur del me humbje			
Përgjigjet e dhëna nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë.			
Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përgjigjet e dhëna nisur nga tema e kaluar.			
REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)			
Mësuesi/ja nëpërmjet shpjegimit sqaron temën dhe çështjet kryesore si:			

-Përcaktimi i P_e dhe Q_e të firmës

-Llogaritja e çmimit mesatar dhe të përgjithshëm.

-Vlerësimin për rastet kur firma qëndron në treg apo jo .Konkretisht: Nëse qëndron në treg, si është gjendja e saj, me fitim pozitiv, negativ apo fitimi 0? Nëse firma është me fitim negativ, cilin rast paraqet firma jonë?


Mësuesi/sja bën një analizë grafike për tu shpjeguar nxënësve rastin kur kompania del me fitim pozitiv:

Kushti i parë: Max i fitimit $MR=MC=P$

(karakteristikë K, plotë) Pasi gjejmë këtë nivel përcaktojmë Q_e ekuilibër, dhe të ardhurat, MC Sipërfaqja O, P_e , E, Q_e paraqet të ardhurat e firmës.

Për të paracaktuar kostot e firmës, për nivelin sasi ekuilibër(Q_e) gjejmë nivelin ATC

Sipërfaqja OLK Q_e paraqet Kostot totale. Sipërfaqja e $TR > TC$ e për pasojë Fitimi pozitiv($TR - TC > 0$)



REFLEKTIMI(Brainstorming)

Për të parë se sa është kuptuar informacioni i dhënë iu bëhen nxënësve pyetjet e mëposhtme:

-Cili është dallimi midis fitimit ekonomik dhe atij kontabël?

-Si përcaktohet niveli optimal i prodhimit për firmën që vepron në konkurrencë të plotë?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

-për përgjigjet e dhëna në fillim të mësimit

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për aktivizimin në tabelë me zgjidhje ushtrimesh

Detyrat dhe puna e pavarur:

Bazuar në të dhënat argumentoni vendimin që duhet të marri firma

$P = 4$ lek $Q = 60$ $TR = 240$ lek $TC = 240$ lekë $TVC = 200$ $TFC = 4$ $\text{Fitimi} = 0$

Hint: $P = MC$ $\text{fitimi} = 0$

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Struktura e tregut monopol		Situata e të nxënit: “Microsoft”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Monopol	
- përkufizon konceptin e monopolit		Licenca	
- shpjegon ç’janë barrierat hyrëse		Patenta	
- liston pengesat e hyrjes në tregun monopol		Marka tregtare barrierë hyrëse	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, dërrasë e zezë, <i>Power point, Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Kubimi - Kubimi			
Organizimi i orës së mësimin			
Evokimi (Brainstorming)			
Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen:			
Çfarë kuptoni me fjalën firmë?			
Përkufizimet e shkruara nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë.			
Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përkufizimet e bëra nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj.			
Realizimi i kuptimit			
Shpjegim i temës dhe çështjeve kryesore:			
-Kuptimi i konceptit monopol			
-Pengesat hyrëse në tregun monopol			
-Licenca			
-Patenta			
-Marka tregtare			

Reflektimi

Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Ç'është monopoli dhe cilët faktorë bëjnë të mundur ekzistencën e tij?
- Ku ndryshon monopoli nga konkurrenca e plotë?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për përgjigjet e dhëna në lidhje me pyetjet e mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim në mësim


Detyrat dhe puna e pavarur:

A ekziston në Shqipëri një treg që është Monopol? Nëse po, çfarë duhet të bëjë Autoriteti i Konkurrencës që kompania të mos jetë abuzuese?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Konkurrenca monopolistike dhe Oligopoli		Situata e të nxënit: Tregu oligopol në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan konkurrencën monopolistike / oligopolin dhe veçoritë e tyre si strukturë tregu; - analizon sjelljen e shitësve dhe blerësve në kushtet e konkurrencës monopolistike dhe oligopolit; - krahason duke evidentuar të përbashkëtat dhe veçoritë e këtyre dy strukturave (avantazhet dhe disavantazhet). 		<p>Konkurrencë monopolistike</p> <p>Oligopol</p> <p>Produkt i diferencuar /i pa diferencuar</p> <p>Kartel</p>	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Legjislacioni shqiptar lidhur me konkurrencën në treg, <i>smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip--charter</i> , USB, informacione e raste studimore të strukturës konkurrencë e plotë.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Të nxënit në bashkëpunim - Kllaster			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Mësuesi/ja merr ide nga gjithë secili fokusuar në pyetjet e mëposhtme:			
1. Duke qenë se deri në këtë moment kemi trajtuar dy nga skajet e segmentit që simbolizonte vendosjen e strukturave në treg dhe kemi parë se midis tyre qëndrojnë Konkurrenca monopolistike dhe Oligopoli a mundet të përpiqemi që me një stuhë mendimesh të hedhim në letër dhe më pas të përpiqemi ti grupojmë veçoritë e këtyre strukturave?			



2. Cilat nga veçoritë e konkurrencës së plotë janë të vlefshme edhe për konkurrencën monopolistike?
3. Cilat janë të veçantat që mund të shfaq në treg një strukturë tregu oligopol si kurse ndodh me telefoninë celulare në Shqipëri?
3. Cilat mendoni se janë lehtësitë dhe vështirësitë e të operuarit në një strukturë të tillë tregu?
4. Vendosni + në tabelën e mëposhtme, nëse mendoni se tiparet e poshtëshënuara janë karakteristikë e secilës strukturë tregu.

Konkurrenca monopolistike karakterizohet nga:

Shumë firma në treg	Informacion i plotë	Hyrje & Dalje e lirë në treg	Produkt i diferencuar	Produkt unik	Marketing i fuqishëm

Oligopoli karakterizohet nga:

Pak firma në treg	Vendime të ndërvarura	Shesin shumicën e produktit në treg	Produkt i diferencuar	Firma të mëdha	Marketing i fuqishëm


REALIZIMI i KUPTIMIT (Të nxënit në bashkëpunim)

Në këtë etapë të orës së mësimit mësuesi/ja mund të saktësojë tiparet e secilës prej strukturave të sipërpërmendura të tregut dhe të krahasojë tabelat e përgatitura nga nxënësit dhe pa harruar shenjat e vendosura prej tyre në secilën prej tipareve .

Në këtë mënyrë argumentohen të gjitha veçoritë që i qëndrojnë secilës strukturë tregu.

REFLEKTIMI (Kllaster)

Mësuesi/ja në këtë etapë të orës së mësimit orienton nxënësit që duke ju referuar modelit teorik të konkurrencës monopolistike / oligopolit dhe shembujve nga realiteti ekonomik në të cilin jetojmë të evidentojnë edhe njëherë karakteristikat e dy strukturave nëpërmjet një kllasteri për secilën strukturë.



Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

-për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për aktivizim gjatë orës së mësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve ju kërkohet të gjejnë dhe të listojnë emrat e firmave, të cilat operojnë në strukturë tregu Konkurrencë monopolistike ose Oligopol në ekonominë shqiptare ose botërore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Puna si faktor kryesor i procesit të prodhimit		Situata e të nxënit: Kërkesa për programe kompjuterike me natyrë ekonomike	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatohet strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathhtësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -përkufizon konceptin punë -analizon veçoritë e tregut të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të faktorit punë -interpretin lakoren e kërkesës për punë nga ana e një firme individuale		Kërkesa për punë, të ardhurat e produktit marxhinal produkti marxhinal i punës të ardhura marxhinale	
Burimet: Libri i nxënësit, dërrasë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Shpjegim-Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI(Brainstorming) Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen: ➤ Çfarë kuptoni me termin punë? Përkufizimet e shkruara nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë. Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përkufizimet e bëra nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj.			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)

Mësuesi/ja nëpërmjet shpjegimit sqaron temën dhe çështjet kryesore si:

Si çdo faktor prodhimi dhe puna del në treg, pra aty ku tregtohet dhe përcaktohet paga dhe fuqia punëtore.


– Këtu lind pyetja se si arrihet në përcaktimin e këtyre treguesve?

Përcaktimi vjen si përputhje e kërkesës për punë dhe ofertës për punë.

- Kush e përfaqëson kërkesën për punë?
- Një përgjigje e menjëhershme do të ishte individi, por në fakt kërkesën për punë e bën firma, e cila kërkon fuqi punëtore.
- Si përcaktohet kërkesa për punë?
- Kërkesa për punë është një kurbë e derivuar, e cila nënkupton që sjellja e saj do të jetë një përkthim i kërkesës për produktet
- Po ofertën kush e përcakton?
- Punën e përcakton ai individ që ofron punën kundrejt pagës.
- Pasi shpjeguam konceptet dhe arritjen e ekuilibrit do të përqendrohemi tek kërkesa për punë.
- Lind pyetja, si e përcakton firma se cili do të jetë niveli që do të maksimizojë fitimin e firmës?

Niveli fitim maksimizues do të arrihet aty ku $MR = MC$, e cila në rastin e tregut të punës do të detajohej si $MRPL$ (të ardhurat marxhinale të produktit nga puna) = $M\ddot{E}C$ (Kosto marxhinale të faktorit punë)

$$\begin{array}{l} MRPL = MR * MP \\ M\ddot{E}C = \Delta T\ddot{E}C / Q \end{array} \quad \longrightarrow \quad MRPL = M\ddot{E}C = \ddot{E}$$



REFLAKTIMI (Brainstorming)

Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Pse puna përbën faktorin kryesor të procesit të prodhimit?
- Pse themi se kërkesa për punë është një kërkesë e derivuar?

- Cila teori qëndron në bazë të analizës së kërkesës për punë?
- Cili është rregulli bazë me anë të së cilit firma përcakton numrin optimal të të punësuarve që i siguron asaj fitimin maksimal?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me përkufizimin e konceptit punë
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimet e bëra gjatë pyetjeve analitike

Detyrat dhe puna e pavarur

Nisur nga njohuritë e marra nëse paga do të ishte 10 njësi dhe P i produktit 5 njësi a mund të përcaktoni sa do të ishte niveli i fitimit maksimizues? Po forca punëtore fitim maksimizuese a mund të përcaktohet?

Nisuni nga formulat e marra

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Oferta e punës dhe ekuilibri në tregun e punës		Situata e të nxënimit: Tregu i punës	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e të shprehurit: Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.</p> <p>Përdor gjuhën e ligjit, të moralit, të ekonomisë dhe politikës për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij</p> <p>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton dhe interpreton lakoren e ofertës për punë për një individ të veçantë dhe për tregun në tërësi - përcakton nivelin e ekuilibrit të tregut të punës dhe nivelin e pagës ekuilibër - argumenton sesi kërkesa dhe oferta përcaktojnë çmimin e punës, kapitalit dhe tokës 		<ul style="list-style-type: none"> oferta e punës efekti i zëvendësimit efekti i të ardhurave paga e ekuilibrit 	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, dërrasë e zezë, <i>Power point, Flip---charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim - Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimi			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Për t'i sjellë më afër temës së re që do të trajtohet në këtë orë mësimi, mësuesi/ja nis me një Brainstorming në lidhje me pyetjet e mëposhtme:			
<ul style="list-style-type: none"> - A mendoni se puna përbën faktorin kryesor të procesit të prodhimit? Pse? - Ç'është kërkesa për punë, si përcaktohet ajo? - Ç'është oferta për punë, si mund të përcaktohet ajo? - Si bashkëveprojnë këto me njëra-tjetrën për të përcaktuar pagën dhe nivelin e punësimit? 			

REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)

Nëpërmjet shpjegimit dhe duke marrë në konsideratë përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja sqaron temën dhe çështjet kryesore si:

- Ofertën e punës
- Efektin e zëvendësimit
- Efektin e të ardhurave
- Ekuilibrin e tregut të punës
- Pagën ekuilibër
- Diferencimet në paga, faktorët që përcaktojnë pabarazinë e tyre

REFLAKTIMI(Brainstorming)

Për të parë se sa është kuptuar informacioni i dhënë iu bëhen nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Pse kurba e ofertës individuale për punë paraqitet në formë të brrylëzuar?
- Si do të përcaktohet paga në qoftë se në tregun e punës do të vepronte “dora e padukshme e Smithit”?
- Cilat forca të tjera veç kërkesës dhe ofertës veprojnë në tregun e punës për të përcaktuar nivelin e pagës?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për përgjigjet e dhëna gjatë pyetjeve analitike
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim gjatë orës së mësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u kërkohet që të kërkojnë pranë sitë të INSTAT dhe të gjejnë të dhëna mbi tregun e punës. Çfarë mund të konkludojnë nga të dhënat e LSMS?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Toka si Faktor kryesor prodhimi		Situata e të nxënit: Qiraja e banesave në Tiranë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .			
Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.			
Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathhtësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		Lakorja e kërkesës /ofertës për tokë	
- përkufizon konceptin tokë		Renta e tokës	
- ndërton lakoren e kërkesës/ofertës për tokë		Ekuilibri në tregun e tokës	
- paraqit në mënyrë grafike ekuilibrin në tregun e tokës			
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, <i>Power point, Flip-charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Shpjegim- Kubimi			
Organizimi i orës së mësimi			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Për t'i sjellë më afër temës së re që do të trajtohet në këtë orë mësimi, mësuesi/ja nis me një brainstorming në lidhje me pyetjet e mëposhtme:			
-Pse kurba e ofertës individuale për punë paraqitet në formë të brylëzuar?			
-Si do të përcaktohet paga në qoftë se në tregun e punës do të vepronte “dora e padukshme e Smithit”?			
-Cilat forca të tjera veç kërkesës dhe ofertës veprojnë në tregun e punës për të përcaktuar nivelin e pagës?			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)			
Nëpërmjet shpjegimit dhe duke marrë në konsideratë përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja sqaron temën dhe çështjet kryesore si:			
Toka është pjesë e faktorëve të prodhimit të diskutuar që në hyrje të librit të ekonomisë nga ekonomistë të shumtë.			

Toka si faktor prodhimi përfshin burimet natyrore si tokë bujqësore, tokë për ndërtim, pyje etj.

Toka mund të shitet apo të blihet të lihet me qera, që do të thotë tregtohet e si pasojë duke krijuar tregun e tokës, Tregu bën përballjen e ofertës dhe kërkesës për tokë.

– Cili do të ishte çmimi për të cilën kërkesit dhe ofruesit do të binin dakord?

Ky çmim do të ishte në nivelin ku kërkesa me ofertën do të barazoheshin dhe në rastin e tokës ky çmim quhet rentë.

– Si do të paraqitej oferta për tokën(bujqësore)



Renta StOferta e tokës është tërësisht inelastike . Arsyja ! Supozimi që përdoret toka vetëm për bujqësi dhe një produkt i caktuar. Megjithatë në

afatgjatë duke u mirëmbajtur dhe ushyer toka mund të bëhet më produktive.

– Si do të paraqitet kërkesa për tokën bujqësore?

Kërkesa është e derivuar nga kërkesa për produkte bujqësore.

$MRP_t = D_t$ Sa më shumë kërkesë për produkte aq me shumë kërkesë



REFLEKTIMI(Brainstorming)

Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

-Çfarë duhet të kemi parasysh kur flasim për tokën si faktor prodhimi?

-Si përcaktohet lakorja e ofertës së tokës dhe pse ajo është krejtësisht joelastike?

-Si ndërtohet lakorja e kërkesës për tokë?

-Si përcaktohet madhësia e rentës?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

-për përgjigjet e dhëna gjatë pyetjeve analitike

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për aktivizim gjatë orës së mësimimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Analizoni: 1) Përse në periudhë afatgjatë oferta e tokës mund të jetë relativisht elastike?

2) Përse çmimi i produkteve bujqësore ndikon në ndryshimin e kërkesës për tokë?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Kapitali, Faktor kryesor prodhimi		Situata e të nxënit: Norma e kthimit në investimet Bar-Restorant.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .			
Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.			
Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatohet strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: - tregon kuptimin ekonomik të kapitalit si faktor prodhimi - bën dallimin midis të mirave kapitale dhe punës apo tokës - përkufizon investimet - shpjegon çfarë është norma e interesit		Kapital fizik Stoku investim normë interesi	
Burimet: Libri i nxënësit, dërrasë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip-charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Shpjegim- Punë e pavarur			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Për t'i sjellë më afër temës së re që do të trajtohet në këtë orë mësimi, mësuesi/ja nis me një Brainstorming në lidhje me pyetjet e mëposhtme:			
-Ju kujtohet, çfarë duhet të kemi parasysh kur flasim për tokën si faktor prodhimi?			
-Si përcaktohej lakorja e ofertës së tokës dhe pse ajo ishte krejtësisht joelastike?			
-Si ndërtohej lakorja e kërkesës për tokë?			
-Si përcaktohej madhësia e rentës?			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)			
Nëpërmjet shpjegimit dhe duke marrë në konsideratë përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja sqaron temën dhe çështjet kryesore si:			

- Kuptimin ekonomik të kapitalit si faktor prodhimi
- Kërkesën për kapital fizik
- Ofertën për kapital fizik
- Investimet dhe normën e interesit

REFLEKTIMI(Punë e pavarur)

Në këtë fazë mësuesi/ja jep të dhënat e mëposhtme dhe kërkon që nxënësit të punojnë fillimisht në fletoret e tyre dhe më pas punohet në tabelë.

Norma e interesit e përcaktuar nga tregu i fondeve të huajtshme është 10%.

Firma dëshiron të realizojë tri investime norma e kthimit e të cilëve respektivisht është 8%, 10%,dhe 12%. Tregoni se cili investim do të ishte fitimprurës për firmën dhe **Pse**

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim gjatë orës së mësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Si paraqitet oferta e kapitalit fizik në periudha afatshkurtra dhe periudha afatgjata?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Roli I qeverisë në ekonomi		Situata e të nxënit: Politikat stabilizuese	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatohet strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme..</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon funksionin e qeverisë si arbitër dhe subjekt në ekonominë e tregut - argumenton shkaqet që e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen e shtetit në ekonomi - evidenton sesi qeveria siguron funksionimin eficient të tregjeve 		<p>Dështim tregu</p> <p>Eksternalitet</p> <p>Cikël biznesi</p> <p>Të mira dhe shërbime publike</p>	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, dërrasë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip--charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming- Organizues grafik- Diskutime			
Organizimi i orës së mësimimit			
Evokimi(Brainstorming)			
Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen:			
➤ Ç'kuptoni me termin ekonomi tregu?			
Përkufizimet e shkruara nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë			
Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përkufizimet e bëra nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj.			

REALIZIMI I KUPTIMIT (Organizues grafik)


Qeveria luan një rol të rëndësishëm në ekonomi. A është vërtet me rëndësi ndërhyrja e tyre?

Qeveria luan disa role:



Pasi përcaktohen rolet mësuesi/ja tashmë shpjegon funksionet që kryen qeveria sipas secilit rol

ROLIFUNKSIONI



Gjatë kohës që mësuesi/ja paraqet në tabelë funksionet dhe rolet, jep dhe shpjegimin e tyre përkatës.

REFLEKTIMI (Diskutime)

Në këtë fazë të fundit të mësimit mësuesi/ja shtron për diskutim pyetjet:

- 1) Veprimtaria e subjekteve ekonomike sjell më shumë eksternalitete negative apo pozitive? Pse?
- 2) Përse është e rëndësishme garantimi i ruajtjes së pronës private? Ku ndikon ky faktor?

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim gjatë orës së mësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Jepni shembuj eksternalitetesh në zonën tuaj të banimit? Si kanë ndikuar ato në jetën tuaj, kanë pasur efekt pozitiv apo negativ. A është marrë ndonjë iniciativë për ti mbështetur ato nëse kanë rezultuar pozitive për shoqërinë nëse po çfarë? Po në rastet kur janë shoqëruar me humbje?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Buxheti i qeverisë		Situata e të nxënësve: Prioritetet e vitit 20XX	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, në mënyrë të grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënësve: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatohet strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxënësve; demonstroi shkathhtësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.</p>			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
Burimet: Libri, video projektor, <i>Flip---charter</i> , internet		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI (Brainstorming) REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)			
Vlerësimi:			
Detyrat dhe puna e pavarur:			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___


Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Taksat, llojet dhe efektet e tyre		Situata e të nxënit: Taksa progresive mbi të ardhurat në Shqipëri	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathhtësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon taksat dhe të dallojë llojet e ndryshme të taksave - identifikon efektet që japin lloje të ndryshme taksash - interpreton raportet e ndryshme të të ardhurave nga taksat e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Taksa taksa e sheshtë taksa progresive taksa të drejtpërdrejta taksa të tërthorta efekte ekonomike të taksimit TVSH 	
Burimet: <p>Legjislacioni shqiptar lidhur me taksat dhe tatimet, <i>smart board</i>, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i>, USB, informacione e raste studimore të strukturës konkurruese e plotë</p>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Kllaster - Leksion i avancuar - Lojë me role			

Organizimi i orës së mësimit

EVOKIMI(Kllaster)


Mësuesi orienton nxënësit në këtë fazë të parë të mësimit zhvillohet një Kllaster në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1 . A dini se çfarë quajmë taksë dhe cilët janë paguesit etyre?




Argumentoni pse po ose jo.

2. Duke ditur se familjet tuaja paguajnë taksë a mund të përmendni se cilat janë ato?



3 A dini cilat janë efektet e taksave dhe kush duhet tëi paguaj ato?



Nëse Po trego se cilat do të ishin parimet mbi të cilat ju mendoni se duhet të vendosen taksat.

REALIZIMI i KUPTIMIT(Leksion i avancuar)

Një hyrje e leksionit realizuar në kllasterin e realizuar nga nxënësit dhe mbështetur në dijet e fituara deri tani, theksi në këtë leksion të avancuar duhet të bjerë në çështje kyç si:

- Kush duhet të paguaj taksë?
- Cilat janë llojet e taksave që aplikohen?
- Cilat janë efektet e këtyre taksave
- Cilat janë llojet e taksave sot në Shqipëri?
- Cilat janë efektet e taksimit në grupe të ndryshme sociale

Këtu mësuesi ndalet dhe ve theksi në faktin që:

Efektet vijnë si rrjedhojë e:

- Taksimit mbi të ardhurat
- Taksimi mbi pasurinë dhe kapitalin
- Taksimin mbi shpenzimet

REFLEKTIMI (Lojë me role)

Nxënësve iu kërkohet të ndahen në grupe me nga 2 vetë dhe në njërin rol mbahet qëndrimi i një përfaqësuesi të zyrës së tatim –Taksave dhe në tjetrin i një Individidi apo Familje .

Përpjekjet e mësuesit/es duhet ta shtyjë secilin grup interesi të mbajë një qëndrim sa më parimor e racional .

Në këtë lojë nxënësit përvetësojnë jo vetëm parimet, llojet e taksave, kohën e vjeljes por edhe një qëndrim brenda etikës profesionale e qytetare.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e parashtruara në fillim të mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për aktivizim gjatë orës së mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve ju jepet detyrë që nëpërmjet kërkimit në faqen zyrtarë të Ministrisë së financave të gjendet raporti në të cilin janë të ardhurat nga taksat e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___ / ___ / ___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Deficiti buxhetor dhe borxhi kombëtar		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: prezanton një projekt kurrikular nga fusha e ekonomisë, të hartuar individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera .</p> <p>Kompetenca e të menduarit: prezanton, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve duke ofruar argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme; vërteton saktësinë e planifikimit dhe tregon me shembuj se si do të zbatojë strategjinë e ndjekur edhe në kontekste të tjera gjatë të nxëni; demonstroi shkathhtësi funksionale e argumentuese të zbatuara në jetën e përditshme..</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: - shpjegon çfarë është deficiti buxhetor - përkufizon borxhin publik - shpjegon raportet e deficitit buxhetor me ekonominë		deficit borxh publik inflacion	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri i nxënësit, dërrasë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip--charter</i>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Rrjet diskutimesh - Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Për t'i sjellë më afër temës së re që do të trajtohet në këtë orë mësimi, mësuesi/ja nis me një Brainstorming në lidhje me pyetjet e mëposhtme: -E mbani mend, cilat janë llojet e taksave dhe pse ishin të domosdoshme ato? -Cilat ishin efektet ekonomike të llojeve të ndryshme të taksave? -Cili është informacioni që keni në lidhje me raportin midis të ardhurave nga taksat e drejtpërdrejta me ato të tërthorta në buxhet?			

REALIZIMI I KUPTIMIT(Rrjet diskutimesh)


Borxhi i shtetit apo siç konsiderohet borxhi publik, është një tregues shumë i rëndësishëm për stabilitetin makroekonomik. Ndërmjet ekonomistëve diskutohet shpesh: A është borxhi i keq?

Mësuesi/ja sqaron paraprakisht:

konceptin e **deficitit buxhetorà** situata ku shpenzimet e shtetit janë më të larta se të ardhurat.

Deficitet buxhetore të grumbulluara nga një vit në tjetrin përfaqësojnë à **Borxhin Publik**.

Tashmë pasi janë dhënë konceptet bazike shtrohet për diskutim pyetja e ngritur më parë: a është borxhi i mirë apo i keq



Argumentet Pro: Argumentet kundër

- 1) Borxh më i vogël se 60% i GDP
- 2) Stimulon ekonominë duke rritur shpenzimet

- 1) Investimet private
Marrja e huasë → redukton fondet për bizneset. → redukton investimet → më pak kapital fizik, më pak vende pune, më pak të ardhura, më pak rritje ekonomike
- 2) Norma të larta interesi
Marrja e kredisë nga shteti përkthehet në rritje të kërkesës për hua, në një treg ku përballet kërkesa me ofertën do të përkthehet në rritje çmimi në këtë rast të normës së interesit
- 3) Inflacion
Rritja e borxhit do të shoqërohet në pagimin e saj në një kohë të mëvonshme e cila do të kërkojë emetim paraje, që përkthehet në inflacion më të lartë
- 4) Rritja e interesit të borxheve publike
Thellohet borxhi më shumë për shkak të mos pagimit.

REFLEKTIMI(Brainstorming)

Në tabelë mësuesi/ja shkruan pyetjen:

Si mendoni Shqipëria me nivelet e borxhit aktual, a duhet të marri më borxh?

Nëse po: me çfarë do të shoqërohej rritja e mëtejshme e nivelit të borxhit?

Nëse jo: Pse?

Nxënësit fillimisht punojnë në fletoret e tyre për të dhënë përgjigjet dhe më pas i diskutojnë ato me zë.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

-për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e parashtruara në fillim të mësimit

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për aktivizim gjatë orës së mësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:


Aksesoni faqen e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, si ka rezultuar borxhi publik vitet e fundit?

A është marrë ndonjë masë për shlyerjen e tij?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Paraja dhe funksionet e saj		Situata e të nxënit: Bota pa para!?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një esse nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		para	
- përkufizon konceptin e parasë		barter	
- liston karakteristikat e parasë		mjet këmbimi	
- liston funksionet e parasë në një ekonomi dhe i shpjegon		matëse e vlerës	
- përshkruan procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë		ruajtëse e vlerës	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Smart board, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, Flip- --charter			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Kllaster -			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Në këtë fazë të parë mësuesi/ja u shtron nxënësve disa pyetje me qëllim që të marrë informacione në lidhje me njohuritë që mund të zotërojnë për temën:			
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Çfarë kuptoni me termin para? Për çfarë përdoret ajo? ➤ Kur dy individ këmbajnë mallra ndërmjet tyre a e përdorin paranë? 			
REALIZIMI I KUPTIMIT (Kllaster)			
Në qendër të tabelës, mësuesi/ja paraqet konceptin bazë të kësaj teme, i cili është paraja, në formë kllasteri dhe së bashku me nxënësit përplojnë ta plotësojnë atë në lidhje me funksionet e saj.:			



Pasi plotësohet kllasteri, mësuesi/ja shpjegon secilin prej tyre.

Paraja si mjet këmbimi siguron:1) Transportueshmërinë

2) Qëndrueshmërinë

3) Uniformitetin

4) Ndashmërinë

5) Stabilitetin

6) Pranueshmërinë

Mësuesi/ja shpjegon shkurtimisht secilën prej tyre

REFLEKTIMI(Pesëvargësh)

Në këto minuta të mbetura mësuesja u kërkon nxënësve të realizojnë një pesëvargësh në lidhje me konceptin “Paraja”, si p.sh:

Paraja

E ndashme /E qëndrueshme

Siguron mat ruan

Paraja shërben si mjet këmbimi

Kartëmonedha

Në fund të kësaj faze nxënës të ndryshëm lexojnë pesëvargëshat e krijuar.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

-për idetë e dhëna

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

-për punën e pavarur

Detyrat dhe puna e pavarur:


Imagjinoni një botë pa para, por me mallra dhe shërbime, siç është bota jonë sot. Mallrat dhe shërbimet do të shkëmbeheshin drejtpërsëdrejti me njëri-tjetrin. Çfarë problematikash mendoni se do të hasnit? Renditini këto problematika dhe krijoni grupe me karakteristika të ngjashme. Çfarë ju thonë këto grupe për përparësitë që sjell në shoqëri paraja?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Format dhe oferta e parasë		Situata e të nxënit: Agregatët monetarë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan si dhe pse lindi paraja - evidenton llojet e ndryshme të parasë si dhe tiparet që duhet të ketë ajo - argumenton se si oferta e parasë është shuma e agregatëve monetarë dhe është produkt i politikave të Bankës qendrore		Fjalët kyçe: Oferta e parasë Format e parasë paraja mall Paraja përfaqësuese Paraja e dekretuar Paraja elektronike Agregat monetar	
Burimet: <i>Smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i> , USB, Botime të Bankës qendrore dhe shkrime lidhur me ofertën monetare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming = Harta e të menduarit - Të nxënit në bashkëpunim – Rrjet i diskutimit + Modeli Dija /Di / Mësova			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI(Brainstorming = Harta e të menduarit) Mësuesi/ja merr ide e gjithë secilit me problemet e mëposhtme dhe ndërton një hartë të të menduarit për 5 nga termat kyç që ko të përmenden në këtë temë si: 1. A mundet të diskutoni dhe të evidentoni rolin e parasë në një shoqëri moderne? 2. A mundet shoqëria e sotme të kishte këtë funksionim nëse do të mungonte paraja? 3. Cilat janë format e parasë që ju dhe familja juaj përdorë dhe cilat janë cilësitë që ajo mbart? 4. A duhet që shuma e parave që qarkullojnë të jetë e barabartë me vlerën e mallrave që prodhon një ekonomi			

6. Evidento në hartën e mëposhtme llojet e parash që njeh?



2. Çfarë dini për paranë mall, paranë përfaqësuese, paranë e dekretuar, paranë elektronike
Shkruani në mini-hartat e mëposhtme fjalët që ju vijnë në kujtesë sapo përmenden këto fjalë.



REALIZIMI i KUPTIMIT (Të nxënësit në bashkëpunim)

Në këtë etapë të orës së mësimit nxënësve ju shpërndahen:

1. Kartëmonedha
2. Karta krediti/Debiti
3. Çek udhëtarësh

Nëpërmjet kësaj teknike nxënësit nxiten të mendojnë nëse ka ende të tjera forma .Stimulohen nxënësit të arrijnë të vetëformulojnë përfundimin se agregatët M1, M2, M3 ndryshojnë nga njëri tjetri nga lehtësi në këmbim.

REFLEKTIMI (Rrjet i diskutimit + Modeli Dija /Di / Mësova)

Të ndarë në grupe nxënësit evidentojnë se sa ishin në gjendje të përkufizoni koncepte si Oferta e parasë, Format e parasë, paraja mall, Paraja përfaqësuese, Paraja e dekretuar, Paraja elektronike. Agregat monetar,

Në tabelën në ndërtuar të gjithë nxënësit shënojnë me + (plus atë që dinte, di ose mësoi gjatë kësaj ore.

	Dija	Di	Mësova
Oferta e parasë			
Paraja mall			
Paraja përfaqësuese,			
Paraja e dekretuar			
Paraja elektronike.			
Agregat monetar			

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e parashtruara në fillim të mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimet në punët me shkrim.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ngarkohen nxënësit të hartojnë një mini-pyetësor me të cilin të shihet se sa shtetasi shqiptarë përdorin njëren apo tjetren formë të parasë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Bankat tregtare dhe roli i tyre si ndërmjetës financiar		Situata e të nxënit: Bankat si ndërmjetës financiar	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.			
Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: - përkufizon çfarë janë bankat tregtare - shpjegon rolin e tyre si ndërmjetës financiar - shpjegon mënyrat e pagesave me anë të bankës		rezerve e detyrueshme paniku bankar, karta krediti hua bankare këmbim valutor çeqe	
Burimet: Libri, tabelë e zezë, <i>Power point</i> , <i>Flip--charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim - Shkrim i lirë (ese)			
Organizimi i orës së mësimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Mësuesi/ja nëpërmjet një Brainstorming-u merr informacion lidhur me pyetjet:			
- Ju kujtohet, cilat janë format e parasë dhe veçoritë e tyre?			
- Çfarë ishte oferta e parasë dhe cilët ishin komponentët përbërës të saj?			
Pasi nxënësit paraqesin përgjigjet e tyre, i pasqyrojmë në tabelë			
REALIZIMI I KUPTIMIT (Shpjegim)			
Mësuesi/ja u shpjegon në këtë fazë se:			
❖ Banka është një nga institucionet, i cili u vjen në ndihmë bizneseve dhe individëve, por që nuk ka qenë përherë ekzistuese. Nxënësve u bëhet një historik sesi ka evoluar sistemi bankar që në kohën kur pagesa bëhej me ar dhe nëpërmjet dëftesave.			


❖ Bankat në ditën e sotme japin hua, dhe mbajnë kursime, të dyja kundrejt normave të interesit. Megjithatë bankat nuk mund të japin kredi të gjithë masën e parasë që kanë, pasi ndalohej me ligj nëpërmjet rezervës së detyrueshme.

❖ **Përse është e nevojshme ekzistenca e rezervës së detyrueshme?**

Nëse një grup njerëzish shkojnë të tërheqin depozitat e tyre në të njëjtin moment dhe banka nuk zotëron masën që duhet t'u kthej për shkak se i ka dhënë kredi, njerëzit do të krijojnë iluzionin dhe do të përhapin ndërmjet tyre që banka s'ka lek. Kjo do të bëjë që të gjithë të kërkojnë lekët e tyre pasi mendojnë se do të humbasin. Ky fenomen konsiderohet si panik bankar.

Përpos funksionit të tyre kryesor (huamarrje) banka kryen dhe shërbime të tjera.

Mësuesja i i shpjegon shkurtimisht:



REFLEKTIMI(Shkrim i lirë, ese)

Në 15-minutëshin e fundit, u kërkohet nxënësve të realizojnë një ese të shkurtër me temën:” Bankat tregtare në Shqipëri”

Përfaqësues të ndryshëm prezantojnë esetë e bëra

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e parashtruara në fillim të mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimet në punët me shkrim

Detyrat dhe puna e pavarur:

Cilat janë pasojat e një paniku bankar në sistemin bankar? Merrni në konsideratë rastet e ndodhura më parë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Sistemi bankar në Shqipëri		Situata e të nxënit: Banka e Shqipërisë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një esse nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - liston funksionet e bankës së Shqipërisë - shpjegon funksionet e bankës së Shqipërisë - tregon veçoritë e sistemit bankar në Shqipëri		Fjalët kyçe: Bankë qendrore stabilitet çmimesh pavarësia transparenca	
Burimet: Libri, dërrasë e zezë, <i>power point</i> , <i>Flip -charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming -			
Organizimi i orës së mësimit Evokimi (Brainstorming) Nëpërmjet Brainstorming-ut kërkohet të merret informacion në lidhje me pyetjen: 1. Si mund ta përkufizoni me fjalët e tuaja termin Bankë. 2. A dini se si është i organizuar sistemi bankar në Shqipëri? 3. Çfarë do të thotë termi banka të nivelit të “dytë”, nëse ju ka rënë rasti ta dëgjoni? Përkufizimet e shkruara nga secili prej nxënësve vendosen në tabelë Evidentohen komponentët e përbashkët të përmendur në përkufizimet e bëra nisur nga etimologjia e fjalës, kuptimi i fjalës në të përditshmen etj. Realizimi i kuptimit Në këtë orë mësimore nxënësve u lejohet që të navigojnë në web e Bankës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë bëhet dhe ndërlidhja me temën e mësimit dhe nxënësit familjarizohen dhe marrin njohuri më shumë mbi Bankën qendrore.			

Nxënësit navigojnë në faqen web të bankës dhe mësuesi/ja i njeh së pari me historikun e bankës, që lidhjet me aspektet se kur është krijuar banka, cilët kanë ndihmuar në krijimin e saj. Duke i njohur me strukturën organizative të këtij institucioni i cili drejtohet nga Guvernatori. Mësuesja shpjegon se Guvernatori është i zgjedhur nga Parlamenti dhe ka një mandat prej 7 vjetësh, kjo edhe për të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

Mësuesja shpjegon se banka është një institucion i pavarur, pra vendimet i merr vetë dhe së dyti është një institucion i cili transparencën e ka në themele të saj.

Mësuesja u kërkon nxënësve ta ndjekin tek faqja web, në seksionin e funksioneve të Bankës së Shqipërisë dhe ua paraqet funksionet për t'u tërhequr vëmendjen edhe në tabelë:



Pasi paraqet funksionet mësuesi/ja i shpjegon shkurtimisht

REFLEKTIMI(Brainstorming)

Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Pse Banka qendrore duhet të jetë një institucion i pavarur dhe nga buron kjo pavarësi?
- Cilat janë disa nga bankat e nivelit të dytë që ju njihni?
- A mendoni se sistemi bankar në vendit tonë është në një situatë të mirë? Jepni mendimin tuaj shkurtimisht.

Vlerësimi: i vazhdueshëm

Nxënësit vlerësohen:

- për mendimet e dhëna në lidhje me pyetjet e parashtruara në fillim të mësimit
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për evidentimin e shembujve nga realiteti ekonomik.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Hyni në faqen e Bankës qendrore dhe gjeni raportet mbi Politikën monetare të ndërmarrë së fundi nga banka. Cili ishte vendimi i saj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Treguesit makro-ekonomik dhe produkti total i ekonomisë		Situata e të nxënit: Përbërësit e PBB	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		GDP	
- përcakton treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë		GNP	
- përkufizon konceptin e GDP-së		GDP nominale	
- krahason GDP reale me GDP nominale		GDP reale	
		Mallra të ndërmjetme/përfundimtare	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
<i>smart board</i> , tabelë magnetike, video projektor, DVD, <i>Flip- -charter</i> , USB, botime të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Brainstorming = Harta e të menduarit - Kllaster - Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimit

EVOKIMI (Brainstorming = Harta e të menduarit)

Mësuesi/ja nis këtë orë mësimit me pyetje nga aktualiteti ekonomik, për të marrë ide nga gjithsecili si p.sh:

1-Çfarë po ndodh me rritjen ekonomike në Shqipëri? A njihni një tregues i cili është përfaqësues i saj?

2-Çfarë ka ndodhur me çmimet në ekonominë tonë?

3-Çfarë është produkti i brendshëm bruto


4- A e dini çfarë dhe cilët janë treguesit ekonomik

Mendimet e nxënësve mësuesi/ja i paraqet në tabelë, duke plotësuar nëse është e nevojshme

REALIZIMI I KUPTIMIT (Kllaster)


Në këtë fazë të mësimit mësuesi/ja, vendos në mes të tabelës temën dhe tenton të bashkëpunojë me nxënësit për shpjegimin e saj.

Mësuesi/ja duke rimarrë përgjigjet mbi pyetjet e mësipërme, paraqet disa nga treguesit kryesor të ekonomisë



Pasi mësuesi/ja bën paraqitje grafike dhe i shpjegon shkurtimisht 3 treguesit, duke u përqendëruar tek GDP.

Mësuesja pyet se çfarë është Produkti i Brendshëm Bruto? (GDP)



➤ Përse ekzistojnë 2 tregues për GDP? Ai nominal dhe ai real?

GDP nominale -----allogarit prodhimin e realizuar rishtazi brenda vitit me çmimet korrente.

GDP reale -----àllogarit prodhimin e realizuar rishtazi brenda vitit me çmime të vitit bazë (që përcaktohet nga Institucionet, dhe që janë vite domethënëse)

➤ **Çfarë paraqet raporti i dy treguesve?**

$(\text{GDP nominale}/\text{GDP reale}) * 100 = \text{zhvlerësues}(\text{deflator})$

Ky raport mat efektin e çmimeve në GDP. Pra e sheshon rritjen artificiale të GDP

REFLEKTIMI(Punë e pavarur)

Në minutat në vazhdim mësuesi/ja u jep nxënësve disa vlerësues statistikor të GDP nominale dhe reale dhe u kërkon të gjejnë zhvlerësuesin

Viti	1	2	3	4
GDP nominale	583369	694098	814797	1088132
GDP reale	564575	658454	794376	1041806
zhvlerësuesi				

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

- për rezultatet e punëve të pavarura.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u kërkohet që të kërkojnë pranë faqes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe INSTAT-it për të dhënat e treguesve të sipërpërmendur. Si rezultojnë ato?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Tipare të tjera të PBB-së dhe metodat e matjes së saj.		Situata e të nxënit: PBB e vitit të kaluar sipas INSTAT.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të menduarit: gjykon vërtetësinë e një rezultati të dhënë (p.sh., rezultatin e një detyre nga ekonomia etj.), i cili mund të jetë gjetur me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e procedurave të caktuara dhe nxjerr përfundime për vërtetësinë e gjykitimit të dhënë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - evidenton saktë cilat janë të mirat dhe shërbimet që përfshihen në PBB - përkufizon dhe përlllogarit PBB për frymë si një tregues i nivelit të jetesës - zbaton dy metodat e llogaritjes së PBB-së dhe argumenton se si PBB mund të llogaritet me këto dy metoda		Fjalët kyçe: Produkte të prodhuara rishtazi GDP/PBB për frymë, Konsum Investime Shpenzime qeveritare eksporte neto,	
Burimet: <i>smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i> , USB, artikuj të marrë nga shtypi i përditshëm apo faqet e agjencive të lajmeve lidhur me GDP Apo GDP për frymë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve -Brainstorming - Leksion i Avancuar - Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI(Brainstorming) Mësuesi/ja individual merr ide për problemet e mëposhtme: 1. A mendoni ju se GDP/PBB është treguesi i cili tregon më së miri nivelin e jetesës së një vendi? A mundet të sillni argumente për të mbrojtur qëndrimet tuaja pro dhe kundër? 2. A dini ju nga e përditshmja dhe realiteti që jetojmë se cilat janë ato të mira që edhe pse prodhohen rishtazi (në vitin korrent) nuk përfshihen në GDP/PBB e atij viti?			

3 . A mendoni ju se niveli i jetesës së një vendi me 7 milionë banorë dhe një tjetër me 70 milionë është i njëjtë nëse ata gjenerojnë të njëjtën GDP në një vit?

4. A mundeni ju të jepni një përkufizim për njërin nga termet si: konsumin, investimet, shpenzimet qeveritare dhe eksportin neto?

Nga totali i përgjigjeve përzgjidhen ato të cilat japin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë përgjigje të cilat kanë lidhje me mësimin e ri .

2. REALIZIMI I KUPTIMIT (Leksion i Avancuar)

Duke qenë se konceptet të tilla si GDP për frymë, konsumi, investimet, shpenzimet qeveritare hasen shpesh në të përditshmen tonë, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve të nxënësve shfrytëzohet përgjatë leksionit duke përkufizuar më saktësisht këto tregues .Konkretisht: metoda e shpenzimeve llogaritet si:Shuma e shpenzimeve të përgjithshme për mallra dhe shërbime përfundimtare të prodhuara gjatë një viti. Krijohet një tabelë me katër kolona dhe evidentohen ato të mira të cilat janë përmendur si pjesë e konsumit/investimeve/shpenzimeve qeveritare etj., në përgjigjet e dhëna në etapën e parë: p.sh:

Konsumi	Investimi	Shpenzime qeveritare	Eksporti neto
ushqime	Makineri	Pagat e arsimtarëve	Diferenca eksport import

Metoda e të ardhurave kërkon që të risjellim në vëmendjen e tyre edhe një herë se cilët janë zotëruesit e faktorëve të prodhimit dhe cilat janë kategoritë e të ardhurave

- | | |
|----------------------------|------------|
| 1. Burimet Natyrore (Toka) | → Renta |
| 2. Burimet Humane (Puna) | → Paga |
| 3. Kapitali | → Interesi |
| 4. Aftësia sipërmarrëse | → Fitimi |

3. REFLEKTIMI (Punë në grupe)

➤ Të ndarë në 4 grupe ripunojnë në idetë e dhëna në pjesën e stuhisë së mendimeve duke i saktësuar ato dhe plotësojnë tabelën me elementet e tjerë të cilët tashmë kanë arritur të kuptojnë se janë pjesë e GDP –së, por që nuk ishin përmendur më parë.

➤ Për secilin nga 4 grupet zgjidhet njëri nga anëtarët për të evidentuar se si GDP është një tregues domethënës por jo gjithçka. Për të argumentuar këtë duhet të sjellë fakte e shembuj të veprimtarive apo të mirave, që nga jetesa në familje apo shoqëri ata e dinë se nuk janë pjesë e deklaruar e GDP.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

Detyrat dhe puna e pavarur:

Duke qenë se në median e shkruar apo atë vizive dëgjojmë të flitet shpesh, për konceptet e trajtuara në këtë temë nxënësve iu kërkohet të bëjnë një analizë krahasimore, të bazuar në të dhënët e INSTAT-it apo të Ministrisë së Financave, apo edhe nga faqet e shtypit (por me shifra nga dy burime) mbi vlerat e GDP-së dhe GDP-së për frymë në dhjetëvjeçarin e fundit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda:	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Papunësia		Situata e të nxënit: Një familje si shumë të tjera	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtaritë të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - përkufizon saktë çfarë është papunësia dhe fuqia punëtore - bën dallimin midis fuqisë punëtore, të papunëve dhe të punësuarve, katër llojet e papunësisë - përllogarit normën e papunësisë dhe argumenton se cilat janë shkaqet e secilës papunësi 		<ul style="list-style-type: none"> Papunësi fuqi punëtore punëzënie e plotë papunësi friksionale papunësi strukturore papunësi ciklike papunësi stinore 	
Burimet: <i>Smart board, Tabelë magnetike, video projektor, DVD, Flip- -charter, USB Artikuj të marrë nga shtypi i përditshëm apo faqet e agjencive të lajmeve lidhur me shifrat e papunësisë.</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve- Brainstorming -Përvijimi i të menduarit - Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Mësuesi/ja kërkon të marrë informacion në lidhje me pyetjet:			
1. A mendoni se papunësia është një fenomen shqetësues ekonomik?			
2. A mendoni se kjo “plagë” “shoqërore mund të mbyllet apo tejkalohet në vendet e zhvilluara?			
3. A mundet të bëni dallimin midis një njeri që në logjikë tuaj quhet i papunë dhe të punësuarit?			

4. A mendoni se jeni pjesë e të papunëve, të punësuarve apo pjesë vetëm e fuqisë punëtore? Pse?

5. A gjykoni se si rrjedhje kalimit të ekonomisë së mjaft vendeve të zhvilluara në Recension numri i të papunëve u rrit?

6. Kur ka pasur Shqipëria "boom" të të papunëve?

Nga totali i përgjigjeve përzgjidhen ato të cilat japin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë përgjigje të cilat kanë lidhje me mësimin e ri .

REALIZIMI I KUPTIMIT (Përvijimi i të menduarit)

Duke qenë se shoqëria jonë është ende e ndjeshme ndaj një problemi si papunësia, përgjithësisht përgjigjet e pyetjeve vijonë në mënyrë të natyrshme e shumë pranë një përkufizimi të saktë.

Kështu që mësuesit nuk i mbetet gjë tjetër veç të riformulojë ato përgjigje që janë shumë pranë përkufizimit shkencor dhe të vijnë mendimin me njohuritë lidhur me katër llojet e papunësisë.

- Papunësia Strukturore
- Papunësia Ciklike
- Papunësia stinore (sezonale)
- Papunësia friksionake (Vullnetare)

REFLEKTIMI (Punë në grupe)

• Të ndarë në 4 grupe (çdo grup një lloj papunësie) nxënësit ripunojnë dhe e rindërtojnë idetë e dhëna në pjesën e parë të mësimin duke i saktësuar ato. Kështu ata arrijnë të riformulojnë ato koncepte për të cilat tashmë kanë arritur të kuptojnë më saktë lidhur me papunësisë.

• Për secilin nga 4 grupet përzgjidhet një person i cili do të argumentojë me mendimin e grupit

• Në të njëjtën mënyrë vazhdohet me evidentimin dhe argumentimin e llojeve papunësisë sot në Shqipëri si edhe shkaqet e kësaj ecurinë e secilës prej tyre.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

-për idetë e dhëna

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Duke qenë se në media-n e shkruar apo atë vizive dëgjojmë të flitet shpesh për konceptet e trajtuara në këtë temë ju jepet nxënësve të bëjnë një pasqyrë të ndryshimit të shifrave të papunësisë nga viti 90 deri 2001. Sugjerohet të përdoren si burim zyrtar të dhënat e e INSTAT.:

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Inflacioni		Situata e të nxënit: Inflacioni dhe pagat e familjes	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon konceptin <i>inflacion</i> dhe të dallojë atë nga deflacioni e disinflacioni - krahason llojet e inflacionit dhe situatat kur shfaqet secili prej tyre - argumenton shkaqet e inflacionit, ndryshimet në normën e inflacionit 		<p>inflacion deflacion disinflacion normë e inflacionit inflacion i moderuar inflacion galopant inflacion nga kërkesa inflacion nga kosto hiperinflacion</p>	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Smart board, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip- --charter</i> , USB Artikuj të marrë nga shtypi i përditshëm apo faqet e agjencive të lajmeve lidhur me inflacionin dhe vlerat e tij në ekonominë shqiptare.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Leksion i Avancuar - Rrjet i diskutimit			

Organizimi i orës së mësimi

EVOKIMI (Brainstorming)

Mësuesi/ja merr ide në lidhje me pyetjet e mëposhtme:

1. A e dini se çfarë quajmë inflacion dhe pse shoqëria ka një ndjeshmëri të madhe lidhur me këtë tregues të ekonomisë?
2. A mundet të themi se shifrat e inflacionit në vendin tonë janë një tregues që e preokupojnë fort shoqërinë shqiptare dhe nëse po pse?
3. Nëse themi që inflacioni është një rritje e përgjithshme e çmimeve a mund të pranojmë se ka situata ekonomike në të cilat hasim jo vetëm rritje por edhe rënie të çmimeve?
4. Në çfarë rrethanash mund të ndodhë kjo rënie çmimesh dhe cilën gjykon si më pozitive për një ekonomi: rritjen apo rënien e çmimeve?
5. A keni dëgjuar për liberalizim të çmimeve? Çfarë kuptoni me liberalizim?

Nga totali i përgjigjeve përzgjidhen ato të cilat japin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë përgjigje të cilat kanë lidhje me mësimin e ri.

REALIZIMI i KUPTIMIT (Leksion i Avancuar)

Duke qenë se konceptet të tilla si: inflacion, deflacion, disinflacion, inflacion i moderuar, inflacion galopant, inflacion nga kërkesa, inflacion nga kosto, hiperinflacion, hasen jo shpesh në të përditshmen tonë, një pjesë e nxënësve mund të hezitojnë të japin përgjigje ose të fokusohen vetëm tek termi inflacion dhe normë e inflacionit.

Bazuar në përgjigjet e nxënësve dhënë në stuhinë e mendimeve mësuesi mund të ndërtojë e prezantojë një punim, në të cilin theksohen ato përcaktime apo dije të cilat nuk mund të merren në të përditshmen tonë, të tilla si:

1. Ndryshimi midis llojeve të inflacionit
2. Rastet kur besimi tek paraja mbetet me gjithë rritjen një apo dyshifrore të çmimeve.
3. Cilat janë situatat kur një ekonomi përballlet me hiperinflacion dhe zgjidhjet e mundshme të këtyre situatave.
4. Kuptimi i spirales Pagë-Çmim, ndikim i saj në jetën ekonomike.
5. Matja e inflacionit dhe dallimi midis një rritjeje të përhershme të çmimeve dhe një rritjeje të vazhdueshme.


REFLEKTIMI (Rrjet i diskutimit)

Në këtë fazë përdoret teknika e rrjetit të diskutimit e cila ju jep mundësinë nxënësve të mund të shprehin mendimin e tyre, ta argumentojnë atë, të ri modelojnë konceptin që kishin më parë duke e saktësuar atë.

1. A ka ndryshime të vazhdueshme të normës së inflacionit në Ekonominë shqiptare?
Argumento pse.

PO

JO



1

1

2

2


3

3

2. A gjykoni se inflacioni në ekonominë shqiptare është pasojë e kërkesës apo e rritjes së kostove të faktorëve të prodhimit?

PO

JO



1

1

2

2

3

3

3. Çfarë ndeshim më shumë në realitetin aktual ekonomik dhe pse?

- Inflacion të moderuar
- Inflacion galopant
- Hiperinflacion

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

-për idetë e dhëna

-për arsyetimet gjatë diskutimit

-për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

Detyrat dhe puna e pavarur:

1. Duke iu referuar ecurisë së shifrave të publikuara në faqet e internetit të Bankës së Shqipërisë si edhe INSTAT-it, evidentoni se cila ka qenë norma e inflacionit në këto 20 vite tranzicion i zgjatur dhe a ka pasur ndonjëherë vlerë negative apo rritja ka qenë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme?


1. Duke u konsultuar me familjarët tuaj, tregoni se cila është dukuria që vihet re në një periudhë parazgjedhore lidhur me shifrat e inflacionit.

45 PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Kostot e papunësisë dhe inflacionit		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton me saktë kostot ekonomike e sociale të papunësisë/inflacionit - krahason këto kosto dhe të arsyetojë cilat prej tyre e bëjnë shoqërinë të reagojë më shpejt - argumenton cilat janë politikat me të cilat qeveria mund të minimizojë efektet e tyre. 		<ul style="list-style-type: none"> kosto të papunësisë kosto të inflacionit kosto ekonomike kosto sociale 	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Smart board, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip- --charter</i> , USB, artikuj të marrë nga shtypi i përditshëm apo faqet e agjencive e lajmeve; botime periodike ose publikime të Bankës qendrore/ Ministrisë së Punës lidhur me inflacionin apo papunësinë			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Përvijimi i të menduarit - Diskutim			
Organizimi i orës së mësimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Mësuesi merr idetë e gjithsecilit në lidhje me pyetjet e mëposhtme:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. A mendoni ju se inflacioni dhe papunësia shoqërohen me kosto si për individin edhe për shoqërinë? 			

2. A mendoni se këto kosto janë vetëm me natyrë ekonomike nëse jo cilat janë këto kosto?
3. Cilat janë kostot pasojat e të cilave ne i ndjejmë në mënyrë të menjëhershme?
4. Cilat janë kategoritë sociale të cilat preken më shumë si rrjedhojë e papunësisë?



5. Cilat janë kategoritë sociale të cilat preken më shumë si rrjedhojë e inflacionit?



Nga totali i përgjigjeve përzgjidhen ato të cilat japin drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë përgjigje të cilat kanë lidhje me mësimin e ri .

REALIZIMI I KUPTIMIT (Përvijimi i të menduarit)


Duke qenë se nga etapa e parë e mësimin nuk mund të evidentohen të gjitha kostot ekonomike dhe jo ekonomike përvijohet mendimi i dhënë nga nxënësit duke vënë theksin në ato kosto të cilat nuk mund të evidentohen menjëherë nga nxënësit në një stuhi mendimesh të tilla si:

Kostot e papunësisë të cilat trajtohen më së shumti si kosto ekonomike .

Këtu mësuesi ve theksin tek kostot sociale të lidhura me:

1. Stresin që përjeton një i papunë
2. Fenomenet që e shoqërojnë një shoqëri me shifra të larta papunësie si: vjedhja, droga, alkooli, krimi i rrugës sëmundjet mendore. . et

Kostot e inflacionit të cilat mund të shkaktojnë një reaksion zinxhir në ekonomi duke qenë se prekin një kategori njerëzish në marrëdhënie ekonomike me njëri-tjetrin.



REFLEKTIMI(Diskutim)

Në këtë fazë shtrohet për diskutim situata:

Nëse banka qendrore vendos të emetojë para për të financuar deficitin dhe borxhin publik, çfarë mendoni se do të ndodhë me inflacionin në afate të mesme dhe të gjata kohore? Kush do ta “paguejë” efektisht këtë borxh?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Duke kërkuar në faqet zyrtare në të cilat publikohen shifrat e papunësisë dhe inflacionit, evidentoni se cilat kanë qenë ritmet e zhvillimit ekonomik dhe rrjedhojat sociale të një papunësie në shifra të larta dhe një inflacioni të mbajtur nën kontroll në këto 10 vitet e fundit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Treguesit makro-ekonomik dhe produkti total I ekonomisë		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja:		GDP	
- përcakton treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë;		GNP	
- përkufizon konceptin e GDP-së;		GDP nominale	
- krahason GDP reale dhe GDP nominale.		GDP reale	
		Mallra të ndërmjetshme/përfundimtare	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Smart board, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, Flip- charter, USB, botime të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming = Harta e të menduarit - Kllaster - Punë e pavarur			

Organizimi i orës së mësimi

EVOKIMI (Brainstorming = Harta e të menduarit)

Mësuesi/ja nis këtë orë mësimi mbi pyetje nga aktualiteti ekonomik, si p.sh:


- 1-Çfarë po ndodh me rritjen ekonomike në Shqipëri? A njihni një tregues i cili është përfaqësues i saj?
- 2-Çfarë ka ndodhur me çmimet në ekonominë tonë?
- 3-Çfarë është produkti i brendshëm bruto?
- 4- A e dini çfarë dhe cilët janë treguesit ekonomik?

Mendimet e nxënësve mësuesi/ja i paraqet në tabelë, duke plotësuar nëse është e nevojshme

REALIZIMI I KUPTIMIT (Kllaster)

Në këtë fazë të mësimi mësuesi/ja, pasi ka vendosur në mes të tabelës temën tenton të bashkëpunojë me nxënësit për shpjegimin e kësaj teme mësimore.


Mësuesi/ja duke rimarrë përgjigjet mbi pyetjet e mësipërme, paraqet disa nga treguesit kryesorë të ekonomisë:



GDP nominale, GDP reale.

Pasi mësuesi/ja bën paraqitje, i shpjegon shkurtimisht 3 treguesit, duke u përqendruar tek GDP-ja.

Mësuesi/ja pyet çfarë është Produkti i Brendshëm Bruto? (GDP)



Përse ekzistojnë 2 tregues për GDP-në? Ai nominal dhe ai real?

GDP nominale -----à llogarit prodhimin e realizuar rishtazi brenda vitit me çmimet korrente.

GDP reale -----à llogarit prodhimin e realizuar rishtazi brenda vitit me çmime të vitit bazë (që përcaktohet nga institucionet, dhe që janë vite domethënëse).

Çfarë paraqet raportin e dy treguesve?

$(\text{GDP nominale}/\text{GDP reale}) \cdot 100 = \text{zhvlerësues(deflator)}$

Mat efektin e çmimeve në GDP. Pra e sheshon rritjen artificiale të GDP

REFLEKTIMI(Punë e pavarur)

Në minutat në vazhdim mësuesja u jep nxënësve disa vlerësues statistikor të GDP nominale dhe reale dhe u kërkon të gjejnë zhvlerësuesin

Viti	1	2	3	4
GDP nominale	583369	694098	814797	1088132
GDP reale	564575	658454	794376	1041806
zhvlerësuesi				

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u kërkohet që të kërkojnë pranë faqes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe INSTAT-it për të dhënat e treguesve të sipërpërmendur. Si rezultojnë ato?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: XII
Tema mësimore: Ciklet e biznesit		Situata e të nxënit: Kriza financiare 2007-2008	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon ciklin e biznesit dhe fazat e tij - identifikon se çfarë fenomenesh e shoqërojnë secilën nga fazat e ciklit - argumenton se cilat janë shkaqet që çojnë në luhatje të tilla ciklike të ekonomisë. 		<p>cikël biznesi</p> <p>pika më e lartë(piku)</p> <p>rënia ekonomike (Recensionioni)</p> <p>pika më e ulët</p> <p>rritja ekonomike (ekspansioni)</p>	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
<p><i>Smart board</i>, tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip- charter</i>, USB, artikuj të marrë nga shtypi i përditshëm apo faqet e agjencive të lajmeve.</p>			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Brainstorming - Leksion i avancuar -Ese			
Organizimi i orës së mësimi			
EVOKIMI(Brainstorming)			
<p>Mësuesi/ja në këtë fazë të parë të mësimi nëpërmjet një Brainstorming-u kërkon të marrë një informacion në lidhje me pyetjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A ka kaluar ekonomi e mjaft vendeve të zhvilluara në fund të viteve 2000 dikë jo fort të mira nga pikëpamja e treguesve ekonomikë? 2. Cilat kanë qenë fenomenet ekonomike që janë shfaqur në ekonominë e këtyre vendeve? 3. Mbështetur në njohuritë e fituara deri tani lidhur me inflacionin dhe papunësinë, a mund të themi se jemi duke jetuar një periudhë në: <ul style="list-style-type: none"> ➤ rritje ekonomike; ➤ rënie ekonomike; ➤ stanjacion (qëndrim në vend)? 			

4. A mundet të listoni faktorë të brendshëm apo të jashtëm që shkaktojnë të tilla luhatje në ekonomi?

REALIZIMI i KUPTIMIT(Leksion i avancuar)

- Një hyrje e leksionit, nisur nga mendimet e dhëna nga nxënësit, mbështetur në dijet e fituara deri tani lidhur me fenomenet dhe treguesit makroekonomik.
- Jepet përkufizimi i Ciklit të biznesit si dhe ndarja e tij në 4 faza:
- Në pjesën e dytë të leksionit për të evituar monotoninë dhe humbjen e përqendrimit, mësuesi/ja përgatit nxënësit për veprimtarinë
- **” Të përshkruajmë se cilat duhet të jetë ecuri a ekonomisë në katër faza të e ciklit të biznesit”** duke u treguar synimin e leksionit dhe objektivat e tij si edhe duke theksuar se tani, ata vetë mund të arrijnë në përfundimin se cilat janë dukuritë që shoqërojnë secilën fazë .
- Mësuesi/ja e ndan klasën në 4 grupe me numër çift dhe u shpjegon detyrën, pra duhet të hartojnë një listë mbi gjithçka që dinë rreth kësaj teme(Fazat e ciklit).
- Mësuesi u kërkon dysheve t’ia tregojnë punën e tyre shokëve. Secili grup hedh në tabelë idetë dhe lidhur me secilën fazë, por pa përsëritur grupin tjetër dhe duke i vendosur një yll(*) atyre veçorive apo fenomeneve që përmenden më shumë se një herë.

Piku	Recension	Pika më e ulët	Ekspansioni

REFLEKTIMI (Ese)

Nxënësve iu kërkohet të shkruajnë një Ese të shkurtër me temë: ”E tashmja dhe e ardhmja e ekonomisë botërore në sytë tuaj”, në të cilën ata mund të japin qëndrimin e tyre lidhur me atë çka shohin apo ndiejnë lidhur me perspektivën e zhvillimeve të ekonomisë sonë dhe asaj botërore.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.


Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u jepet detyrë të lundrojnë në internet dhe të hulumtojnë lidhur me zhvillimet ciklike në ekonominë botërore, si dhe cila ka qenë kriza më e fortë që ka përfshirë ekonominë botërore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Politika Monetare		Situata e të nxënit: Stabilizuesit automatik në veprim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të nxënit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi etj.).			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përkufizon politikën monetare - përshkruan instrumentet e politikës monetare		Fjalët kyçe: politika monetare operacionet e tregut të hapur norma e skontos norma e rezervës së detyrueshme	
Burimet: Libri, internet, <i>Flip-charter</i> , tabelë magnetike, video-projektor, raporte të politikës monetare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Organizues grafik			
Organizimi i orës së mësimt EVOKIMI(Brainstorming) Mësuesi/ja pyet nxënësit për të marrë informacion nga gjithsecili prej tyre. Pyetjet ndihmëse janë: ➤ Çfarë kuptoni me Politikë Monetare? ➤ Kush e zbaton dhe monitoron atë? ➤ Çfarë ka ndodhur së fundi me politikën monetare (fuqizimi i lekut kundrejt euros) Mësuesi/ja përgjigjet e nxënësve i shënon në tabelë dhe plotëson REALIZIMI I KUPTIMIT(Organizues grafik) Në këtë fazë të mësimt mësuesi/ja rimerr dhe njëherë konceptin kyç të kësaj teme dhe nëpërmjet organizuesve grafik sqaron:			



Cilët janë instrumentet e saj

- Operacionet e tregut të hapur(shit/blerje e bonove)
- Norma e skontos (norma e interesit të huasë për bankat e nivelit të dytë)
- Norma e rezervës së detyrueshme (rezerva që mbahet nga bankat si% e depozitave)

Mësuesja i shpjegon me detaje hartën e lart përmendur.

REFLEKTIMI(Brainstorming)

- Si do të ndikonte blerja e bonove nga Banka qendrore?
- Si do të ndikonte në ofertën monetare një rritje e rezervës së detyrueshme?

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitik.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pasi të keni lexuar mësimin, dhe informacionin e dhënë në fund të mësimit, si mendoni: cila është shkolla që për ju ka pikëpamjen më të përshtatshme? Argumentoni përgjigjen.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Kritikë për Politikën Fiskale dhe për Politikën Monetare		Situata e të nxënësve:	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të nxënësve dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi etj.).			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: -dallon instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale -përshkruan ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale, si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare; -identifikon rrugët përmes së cilave politika monetare ndikon te papunësia, te prodhimi, tek inflacioni dhe te normat e interesit; -shpreh qëndrimin e vet për politikën ekonomike në këndvështrimin e stabilitetit ekonomik		Fjalët kyçe: Politika Fiskale Politika Monetare	
Burimet: Libri, internet, <i>Flip -charter</i> , tabelë magnetike, video- projektor, raporte të politikave fiskale dhe atyre monetare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve - Brainstorming - Shpjegim - Brainstorming			
Organizimi i orës së mësimimit EVOKIMI(Brainstorming) Mësuesi/ja pyet nxënësit për të marrë informacion nga gjithsecili prej tyre. Pyetjet ndihmëse janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Çfarë është politika fiskale? ▪ Çfarë është politika monetare? ▪ Cilët janë instrumentet e tyre? 			

REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)

Në këtë pjesë mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit tenton të shpjegojë duke vënë përballë 2 politikat Politikën Fiskale dhe Politikën Monetare)dhe të përcaktojë mangësitë e tyre.

Politika Fiskale**VS** Politika Monetare

□ Mangësitë e Politikës Fiskalemësuesi/ja i sqaron:

- Kur qeveria ul taksat për të luftuar një rënie ekonomike, të ardhurat e buxhetit bien, prandaj qeveria duhet të marrë hua për të përballuar shpenzimet e saj. Për rrjedhojë, borxhi kombëtar rritet. Duke qenë se qeveria merr hua nga publiku për të kompensuar uljen e taksave, ajo zvogëlon huamarrjen e sektorit privat, sepse pakëson ofertën e fondeve të gatshme për huazim. Kjo mund të çojë në një rritje të normës së interesit, duke vështirësuar huamarrjen e individëve dhe të firmave. Për rrjedhojë, një ulje taksash që shoqërohet me huamarrje mund ta përkeqësojë më shumë rënie ekonomike, sepse zvogëlon investimet e biznesit.
- Qeveria mund ta financojë borxhin e saj edhe nëpërmjet emetimit të parasë ose siç njihet ndryshe shtypjes së parasë, e cila çon në rritje të ofertës monetare dhe në rritje të shpenzimeve të konsumatorëve dhe të firmave. Por, një rritje më e lartë e ofertës monetare se rritja në produktivitet nxit inflacionin nëpërmjet rritjes së çmimeve. Për këtë arsye, shumë ekspertë dhe ekonomistë e kundërshtojnë këtë praktikë.
- Problemet politike që shoqërojnë politikat fiskale i bëjnë ato shpesh të pazbatueshme. Politikat fiskale mund të kërkojnë rritje taksash ose ulje shpenzimesh qeveritare gjatë periudhave inflacioniste, por as qeveria dhe as parlamenti nuk dëshirojnë ta bëjnë atë, e sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve.
- Kritikët argumentojnë se askush nuk e di me saktësi se kur duhet të hartohet dhe të zbatohet politika fiskale që të funksionojë mirë. Moszbatimi në kohën e duhur i një politike fiskale më shumë bën keq, sesa mirë.

□ Mangësitë e Politikës Monetare

- Politikat monetare mund të ndryshohen ose të përshtaten më lehtë dhe më shpejt, por efektet e normave më të larta ose më të ulëta të interesit dhe të ndryshimeve të ofertës së parasë janë më të padukshme dhe shpesh kërkojnë kohë më të gjatë për t'u përhapur në ekonomi.
- Politika monetare është më pak efektive në pikat ekstreme të ciklit të biznesit. Gjatë periudhës së ekspansionit (kur optimizmi i blerësve dhe i shitësve është i lartë dhe çmimet rriten), banka qendrore mund të përpiqet të ulë shpenzimet dhe nëpërmjet tyre edhe çmimet, duke rritur normat e interesit
- prirjet integruese të ekonomive vendase në ekonominë botërore, dobësojnë aftësinë e bankës qendrore për të kontrolluar normat e interesit

Pasi shpjegohen mangësitë e të dyja politikave mësuesi/ja thekson rëndësinë e tyre

REFLEKTIM(Brainstorming)

Cilat prej politikave fiskale dhe monetare të përmendura duket se na bën të reagojmë më shpejt, meqenëse efektet e saj mbërrinë te ne në një periudhë tjetër? Argumentoni.

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna;
- për arsyetimet gjatë diskutimit;
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitik.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Si mendoni, cila nga politikat e ndërmarra nga qeveritë shqiptare në vitet e fundit, kanë garantuar stabilitetin e ekonomisë sonë?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

v

Fusha:	Lënda: Ekonomia 12	Shkalla:	Klasa:
Tema mësimore: Shkaqet e tregtisë ndërkombëtare		Situata e të nxënimit: Menaxhere ekzekutive vs financiere e ndërmarrjes	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera. Kompetenca e të nxënimit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi etj.).			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shpjegon konceptet e përparësisë absolute dhe asaj krahasuese - argumenton përfitimet që kanë vendet kur këmbejnë midis tyre.		Fjalët kyçe: eksport, import, përparësi absolute/ relative/ krahasuese ligji përparësive krahasuese çmim relativ	
Burimet: <i>Smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, <i>Flip -charter</i>		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim - Punë e pavarur, Ushtrime			
– Organizimi i orës së mësimit EVOKIMI(Brainstorming) Mësuesi/ja pyet nxënësit në lidhje me tregtinë ndërkombëtare për të marrë informacion nga gjithsecili prej tyre. Pyetjet ndihmëse janë: – A blini produkte kur shkoni me pushime? – A blini produkte në faqet online si “Amazon”? – A dini ndonjë produkt që shitet në Europë apo më gjerë i cili është prodhim vendas? – Përse blini produkte të huaja? – Mësuesi/ja diskuton përgjigjet me nxënësit REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim) Mësuesi/ja shpjegon rëndësinë e tregtisë ndërkombëtare, biseda mund të nisi me fenomenin e globalizimit, për të shpjeguar se sa afër janë vendet pavarësisht pozitës gjeografike Mësuesi/ja shpjegon konceptin e eksporteve dhe importeve:			

- Eksporte-à produkte, mallra që prodhohen në Shqipëri dhe konsumohen nga të huajt
- Importe-à produkte, mallra që prodhohen nga të huajt dhe konsumohen nga shqiptarët
- **Përse ekziston Importi dhe eksporti?**

Ekonomitë e ndryshme nuk mund të prodhojnë çdo produkt për të cilën mund të ketë nevojë shoqëria, e për pasojë ekziston import-eksport.

Ekonomitë mund të kenë përparësi absolute dhe krahasuese, të zhvilluara nga autorët SMITH dhe RIKARDO

Përparësi absolute nënkupton kosto më të ulët të produktit të dhënë, krahasuar me vendin tjetër

Përparësi krahasuese nënkupton çmim relativ më të ulët të një malli në vendin e dhënë, krahasuar me vendin tjetër.

Për t'i ilustruar, mësuesi/ja jep një shembull për të gjetur përparësitë absolute dhe relative:

<i>Kostot për njësi</i>	<i>Vendi A</i>	<i>Vendi B</i>
Stofra (€/m)	4	8
Qumësht (€/litër)	10	6

Duke ilustruar pikëpamjen e SMITH, mbi përparësitë absolute, vendi A ka përparësi absolute në stofra, dhe B në Qumësht, pra A eksporton stofra dhe importon qumësht dhe B anasjelltas.

Ndërsa, për sa i përket pikëpamjes së RIKARDOS, mbi përparësitë krahasuese do të kishim:

<i>Kostot për njësi</i>	<i>Vendi A</i>	<i>Vendi B</i>
Stofra (€/m)	5	4
Qumësht (€/litër)	10	4

Vendi B është më produktiv, domethënë ka përparësi absolute në të dyja produktet, krahasuar me vendin A. Atëherë krahasojmë çmimet relative:

<i>Çmimet relative</i>	<i>Angli</i>	<i>Portugali</i>
Stofra (litra qumësht/m stofra)	0,5	1
Qumësht (m stofra/litër qumësht)	2	1

Çmimi relativ i stofrave të prodhuara në vendin A është llogaritur duke pjesëtuar koston për njësi të stofrave, me koston për njësi të qumështit. Në të njëjtën mënyrë është vazhduar edhe me llogaritjen e çmimeve të tjera relative. Sipas tabelës, vendi B ka përparësi krahasuese në qumësht ($1 < 2$), specializohet në qumësht dhe eksporton atë dhe importon stofra i eksporton ato, ndërsa importon qumësht.

REFLEKTIMI (Punë e pavarur, Ushtrime) Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të ndjekin hap pas hapi ilustrimin e mësipërm dhe të gjejnë:

- Përparësitë absolute
- Çmimet relative
- Përparësitë krahasuese dhe çfarë do importojnë dhe eksportojnë

<i>Kostot</i>	<i>Vendi A</i>	<i>Vendi B</i>
Stofra (orë pune/m)	1	2
Qumësht (orë pune/litër)	2	3

Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitik.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Italia është një nga partnerët tanë kryesorë për sa u përket importeve dhe eksporteve. Gjeni cilat janë grup-mallrat që Shqipëria eksporton në Itali? Cilët mund të jenë faktorët që kanë ndikuar? Të dhënat mund t'i aksesoni në faqen e INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Tregtia e lirë dhe Proteksionizmi		Situata e të nxënimit: Tarifat mbi importet	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.)</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet e saj ekonomike - përshkruan disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare - jep në mënyrë të përmbledhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë 		<ul style="list-style-type: none"> tregti e lire politika proteksioniste, tarifa mbi importin pengesa administrative subvencione 	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, <i>smart board</i> , Tabelë magnetike, video-projektor, <i>Flip -charter</i> , faqja e WTO			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim -			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI (Brainstorming)			
Mësuesi/ja pyet nxënësit nëse kanë lexuar apo dëgjuar për politikat që presidenti Trump kërkonte të ndërmernte.			
<ul style="list-style-type: none"> - A i dini arsyet pse ai kërkonte të vendoste këto politika? - A e dini pse donte të reduktonte deri në bllokim të tregtisë me Kinën? - A e dini sesa janë eksportet e Kinës në botë? - A keni dëgjuar për Tregtinë e Lirë? 			
Pasi nxënësit përgjigjen mësuesi/ja nxit diskutimin në mënyrë që të nxënësit të ndihen më të familjarizuar me temën.			

REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)


Tregtia e lirë VS Proteksionizmi

Tregtia e lirë Nënkupton këmbimin e mallrave dhe shërbimeve pa masa penguese ose kufizuese

Proteksionizmin nënkupton masa kufizuese ndaj tregtisë, veçanërisht ndaj importit.

Pasi mësuesi/ja merr përgjigjet e pyetjeve ajo shpjegon shkurtimisht çfarë ka në thelb të tregtisë së lirë dhe shpjegon pse llohet për tregtinë e lirë, me të cilën merret WTO (OBT). Mësuesi/ja i këshillon nxënësit që për informacione më të detajuara mund të navigojnë në faqen e Organizatës Botërore të Tregtisë(OBT)


Nga ana tjetër Proteksionizmi është një politikë e cila ka ekonomistë që e mbështesin. Kufizimet që aplikohen



Mësuesi/ja paraqet efektet e vendosjes së secilës prej tyre.

REFLEKTIMI (Diskutim)

Mësuesi/ja shtron për diskutim çështjen:



Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitik.

Detyrat dhe puna e pavarur:


Gjatë dekadave të fundit vërehet një prirje e uljes së normave tarifore në Shqipëri. Cilat mendoni se janë disa nga pasojat pozitive të uljes së tarifave? Po kostot e kësaj uljeje?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha:	Lënda: Ekonomia `12	Shkalla:	Klasa: 12
Tema mësimore: Kursi e këmbimit valutor dhe tregtia		Situata e të nxënimit: Kursi i këmbimit të lekut	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe:			
<p>Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: diskuton në grup në mënyrë konstruktive, të përmbledhur, duke dhënë e duke marrë informacion për një temë të caktuar; prezanton një ese nga fusha e shoqërisë dhe mjedisit, të hartuara individualisht ose në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit dhe të mësuarit: paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, etj.).</p>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: -përshkruan luhatjen e kurseve të këmbimit valutor; -bën dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar		kursi i këmbimi valutor bilanci i llogarisë rrjedhëse, Llogaria e kapitalit, llogaria financiare.	
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri, <i>Smart board</i> , tabelë magnetike, video-projektor, DVD, <i>Flip-charter</i> , internet, web i Bankës qendrore			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstorming - Shpjegim - Diskutim			
Organizimi i orës së mësimimit			
EVOKIMI(Brainstorming)			
Mësuesi/ja kërkon të marrë informacion në lidhje me pyetjet:			
<ul style="list-style-type: none"> - A e njihni konceptin kurs këmbimi? Çfarë kuptoni me të? - Shqipëria njihet si një vend me euroizim të lartë? A e dini çfarë do të thotë kjo? 			
Mësuesi/ja shënon përgjigjet e nxënësve në tabelë			
REALIZIMI I KUPTIMIT(Shpjegim)			
Mësuesi/ja jep kuptimin e kursit të këmbimit.--> është çmimi i një valute (monedhe), në termat e një monedhe tjetër.			
Pasi jep konceptin jep një shembull konkret në lidhje me kursin e këmbimit të lekut me euro = 127.85 lek/euro pra për të këmbyer lekun me euro sot duhet të japësh 127.85 lek për të marrë një euro.			

Cilët janë disa faktorë që ndikojnë në uljen apo rritjen e kursit të këmbimit?




Pasi shpjegohen faktorët që ndikojnë në lirësinë apo shtrenjtimin e kursit të këmbimit, vlen të theksohet se situata e tij është e lidhur me **bilancin e pagesave**, i cili është një pasqyrë kontabël e transaksioneve të kryera midis rezidentëve dhe jo rezidentëve të një vendi.

Tri pjesët kryesore të bilancit të pagesave, janë: **bilanci i llogarisë rrjedhëse**, **bilanci i llogarisë së kapitalit** dhe **bilanci i llogarisë financiare**. Mësuesja paraqet në tabelë pjesët përbërëse të secilit bilanc.

REFLAKTIMI(Diskutim)

Mësuesi/ja shtron për diskutim pyetjen:



Vlerësimi: i vazhdueshëm.

Nxënësit vlerësohen:

- për idetë e dhëna
- për arsyetimet gjatë diskutimit
- për arsyetimin e dhënë gjatë pyetjeve analitike.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Bilanci i pagesave të Shqipërisë karakterizohet nga një deficit tregtar tejet i larë. Megjithatë, kursi i këmbimit të lekut ka qenë i qëndrueshëm. Si mund të shpjegohet ky fenomen?